

PËRMBAJTJA

Parathënie	iii
Mirënjohje	iv
Shkurtime	v
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
I. METODOLOGJIA	4
II. ZOTËRIMI DHE PËRDORIMI I LLOGARIVE TË TRANSAKSIONEVE DHE INSTRUMENTET ELEKTRONIKE TË PAGESAVE	7
III. PIKAT E AKSESIT	8
IV. KOSTOT E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL SIPAS AKTORIT DHE PËR EKONOMINË NË TËRËSI	11
IV.1. Konsumatorët	11
IV.2. Bizneset	14
IV.3. Agjencitë Qeveritare	15
IV.4. Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave dhe Ofruesit e Infrastrukturës së Pagesave	17
IV.5. Ekonomia në tërësi	21
V. KURSIMET NË EKONOMI	22
VI. PËRFUNDIME	23
ANEKSI A: NDARJA E KOSTOVE PËR KAHUN E OFERTËS SIPAS INSTRUMENTIT TË PAGESËS	28
ANEKSI B: SHEMBUJ TË PYETËSORËVE TË ANKETIMIT	31
REFERENCA	35
HAPËSIRAT INFORMUESE, TABELAT DHE FIGURAT	
Hapësira informuese 1: Administrimi i anketimit për palët e ndryshme të interesit	4
Hapësira informuese 2: Shembuj të pyetjeve për anketimin e konsumatorëve	31
Hapësira informuese 3: Shembuj të pyetjeve për anketimin e bizneseve	32
Hapësira informuese 4: Shembuj të pyetjeve për anketimin e agjencive qeveritare	33
Hapësira informuese 5: Shembuj të pyetjeve për anketimin e ofruesve të shërbimeve të pagesave	34
Tabela 1: Llojet e pagesave me vlerë të vogël	4
Tabela 2: Raportet e përdorimit për kartat e pagesave ndër vite	7

Tabela 3: Kostot vjetore për agjencitë qeveritare sipas instrumentit të pagesës (2014)	16
Tabela 4: Kostot totale në ekonomi për gjithë instrumentet e pagesave me vlerë të vogël të ekzaminuara /shqyrtuara (2016)	21
Tabela 5: Skenarë zëvendësimi dhe kursimet në nivel ekonomie	23
Tabela 6: Skenarë zëvendësimi dhe kursimet për tregues raste përdorimi nëpër aktorë të ndryshëm	24
Figura 1: Metodatat treguese të transmetimit	5
Figura 2: Pikat e Aksesit ndër kohë	9
Figura 3: Kartat aktive të pagesave në qarkullim ndër kohë	10
Figura 4: Kostot vjetore për konsumatorët për instrument pagese si % e PBB të 2014	13
Figura 5: Kostot për transaksion sipas instrumentit të pagesës nëpërmjet metodave të transmetimit	13
Figura 6: Kostot për transaksion sipas metodës së transmetimit për instrumentet e pagesave	13
Figura 7: Kostot vjetore për bizneset sipas instrumentit të pagesës si % e PBB të 2014	15
Figura 8: Vëllimi i pagesave/transfertave të procesuara në formë letër kundrejt kanaleve elektronike ndër kohë	16
Figura 9: Vëllimi i pagesave/transfertave të procesuara sipas instrumentit të pagesës ndër kohë	18
Figura 10: Vëllimi i depozitimeve dhe tërheqjeve të <i>cash</i> -it ndër kohë	18
Figura 11: Kostot vjetore për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe të infrastrukturës sipas instrumentit të pagesës si % e PBB të 2016	19
Figura 12: Kosto e procesimit për transaksion sipas instrumentit të pagesës	20
Figura 13: Treguesit e kostos për industrinë e kahut të ofertës për Shqipërinë (2016)	21
Figura 14: Kostot e përgjithshme të ekonomisë (burimet) sipas instrumentit të pagesës si % e PBB të 2016	21

PARATHËNIE

Modernizimi i sistemeve të pagesave është kthyer në një përbërës të rëndësishëm të axhendës së reformës të sektorit financiar në shumë vende të përparuara dhe në zhvillim. Për qeveritë dhe bankat qendrore, forcimi i sigurisë dhe besueshmërisë së sistemeve kombëtare të pagesave, së bashku me nxitjen e përdorimit të instrumenteve efektive të pagesave janë qëllime të rëndësishme të politikës publike. Përdorimi më i gjerë i pagesave elektronike kundrejt cash-it dhe instrumenteve të tjera në formë letër ka përfitime të rëndësishme ekonomike dhe sociale, duke përfshirë uljen e kostove dhe rrjedhimisht rritjen e efikasitetit ekonomik, si dhe për zgjerimin e aksesit në shërbimet financiare për ata që aktualisht janë të përjashtuar. Nga ana tjetër, përfitimet e efikasitetit të kostos së instrumenteve të pagesave elektronike kundrejt instrumenteve të pagesave në formë letër mund të jenë një nxitje e fortë për reformat dhe masat e të gjitha palëve të interesuara. Megjithatë, shpesh autoritetet kombëtare dhe palët e interesuara mund të hasin vështirësi në mbështetjen dhe monitorimin e përpjekjeve për reformën e pagesave me vlera të vogla për shkak të vështirësive për të përcaktuar kostot e shkaktuara në këtë treg dhe kursimet që mund të arrihen nëse ndërmerren disa reforma të caktuara.

Grupi i Bankës Botërore ka hartuar "Një Udhëzues Praktik për Matjen e Kostove të Pagesave me Vlerë të Vogël"¹, i cili mbush një boshllëk në këtë hapësirë dhe lejon identifikimin sistematik, mbledhjen dhe matjen e të dhënave, që lidhen me kostot e instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël, për kahun e kërkesës dhe ofertës në zinxhirin e pagesave. Udhëzuesi plotëson dokumentet e tjera të politikave dhe udhëzimeve të publikuara si pjesë e Paketës së Pagesave me Vlerë të Vogël të Bankës Botërore. Për më

tepër, ai lejon zhvillimin e skenarëve të zëvendësimit (nga instrumentet në formë letër tek instrumentet e pagesave elektronike) dhe kursimet e kostos si rezultat i këtij zëvendësimi. Udhëzuesi mund të përshtatet me rrethanat specifike të vendit, pa humbur natyrën e tij krahasuese, në kohë dhe në vende të ndryshme. Udhëzuesi është ndërtuar mbi katër parime kryesore: zbatueshmëria - krahasueshmëria - efikasiteti - standardizimi.

Promovimi i funksionimit normal të sistemeve të pagesave është në qendër të mandatit të Bankës së Shqipërisë, e cila mban rolin e operatorit të sistemeve, mbikëqyrësit dhe një rol katalizator në zhvillimin e sistemit kombëtar të pagesave. Nën udhëheqjen e Bankës së Shqipërisë u krijua Komiteti Kombëtar i Sistemit të Pagesave (KKSP), me objektivin për të mbështetur dhe kontribuar në rritjen e sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemit kombëtar të pagesave në Shqipëri. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë dhe Grupi i Bankës Botërore nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, me objektiv zbatimin e Udhëzimit të Bankës Botërore për matjen e kostove për pagesat me vlerë të vogël në Shqipëri. Rezultatet e studimit do t'i mundësonin Bankës së Shqipërisë, të mbështesë politikën e sistemit të pagesave në një analizë gjithëpërfshirëse të tregut të pagesave me vlerë të vogël, dhe të identifikojë veprimet kyçe për përshtetjen e tranzicionit të pagesave nga cash-i ose në formë letër, në pagesa elektronike. Rezultatet do t'i mundësonin gjithashtu industrisë, si edhe konsumatorëve dhe bizneseve të identifikojnë masat e mundshme që do të çonin në një përdorim më eficient të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël.

Ceyla Pazarbasioğlu
Drejtor i Lartë
Financë, Konkurrenca dhe
Inovacioni
Banka Botërore

Elisabeta Gjoni
Zëvendësguvernator i Parë
Banka e Shqipërisë

1. Versioni i plotë i Udhëzuesit në anglisht: <http://documents.worldbank.org/curated/en/255851482286959215/pdf/111216-WP-P155382-PUBLIC-ABSTRACT-SENT.pdf>

MIRËNJOHJE

Përgatitja dhe publikimi i këtij raporti nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen bujare të Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), përmes Programit të Remitancave dhe Pagesave (RPP) në Ballkan, si dhe Departamentit për Zhvillimin Ndërkombëtar, nëpërmjet Programit të Shfrytëzimit të Inovacionit për Përfshirjen Financiare.

Autorët kryesorë të raportit janë Holti Banka (Banka Botërore) dhe Maria Teresa Chimienti (Banka Botërore). Mbështetje është ofruar dhe nga Anjeza Beja dhe Valentina Semi (të dyja nga Banka e Shqipërisë). Udhëzimi i përgjithshëm u sigurua nga Harish Natarajan (Drejtues , Banka Botërore). Ceu Pereira ishte Udhëheqëse e Grupit të Punës të Programit të Remitancave dhe Pagesave,

Banka Botërore. Sharmista Appaya, Keler Gjika, Johanna Jaeger dhe Gynedi Srinivas (të gjithë nga Banka Botërore) dhanë komente të dobishme gjatë rishikimit të materialit. Skuadra i është gjithashtu mirënjohëse Mahesh Uttamchandani (Udhëheqës në Praktikë, Përfshirja Financiare, Infrastruktura dhe Aksesit, Banka Botërore), Mario Guadamillas (Udhëheqës në Praktikë, Evropë dhe Azia Qendrore, Financat, Konkurrenca dhe Praktikrat Globale të Inovacionit, Banka Botërore), Massimo Cirasino (Banka Botërore), Thomas Lammer (Banka Botërore) dhe Oya Pinar Ardic Alder (Banka Botërore). Charles Hagner ofroi asistencë editoriale dhe Naylor Design Inc. ofroi asistencë dizajnimi dhe paraqitjeje grafike.

AKRONIME DHE SHKURTIME

ATM	Automated Teller Machine - Bankomat
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
POS	Pikë Shitjeje
PIP	Ofruesi i Infrastrukturës së Pagesës
PSP	Ofruesi i Shërbimit të Pagesës
PSU	Përdoruesi i Shërbimit të Pagesës

Gjithë shumat në dollarë janë dollarë amerikanë, përveç nëse shkruhet ndryshe.

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky Raport bazohet në një studim të kostove të pagesave të vogla në Shqipëri, i cili përdor një metodologji të hartuar nga Grupi i Zhvillimit të Sistemit të Pagesave të Bankës Botërore. Duke zbatuar këtë metodologji për rastin e Shqipërisë, studimi synon të krijojë një bazë të shëndoshë ekonomike për sistemin kombëtar të pagesave të vogla në aspektin e kostove të instrumenteve të ndryshme të pagesave, në mënyrë që të udhëheqë më mirë zhvillimin e sistemit dhe të mundësojë ndryshime me një ndikim të lartë. Rritja e efikasitetit që vjen nga zhvendosja drejt instrumenteve të pagesave të vogla me kosto të ulët dhe një përdorim më efikas i këtyre instrumenteve, mund të kenë përfitime të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik dhe të arrijë në familjet me të ardhura më të ulëta.

Në vitin 2014, 38.5% e të rriturve shqiptarë kishin akses në një llogari bankare, ndërkohë që 24% dhe 3.5% zotërojnë përkatësisht një kartë debiti ose një kartë krediti². Që nga anketimi i fundit në kahun e kërkesës, të dhënat nga kahu i ofertës tregojnë se ka pasur një rritje modeste në numër të llogarive bankare për 100,000 të rritur (4.8% në bazë mesatare vjetore). Paraja elektronike, e cila është prezantuar në tregun shqiptar së fundmi, dhe rrjedhimisht nuk është matur në pyetësoin e kahut të kërkesës të vitit 2014, ka arritur në 177,000 llogari në vitin 2016. Kartat e debitit dhe kreditit në qarkullim për 100,000 të rritur, gjithashtu janë rritur nga viti 2014 në 2016, megjithëse rritja u ngadalësua në vitin 2016 (nga 10.4%, në 5.5% për kartat e debitit; dhe nga 6.8%, në 5.5% për kartat e debitit).

Për të përshpejtuar aksesin në llogaritë bankare, një nga rekomandimet e këtij raporti është se Banka e Shqipërisë, bankat dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve të pagesave (duke përfshirë edhe Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave) mund të eksplorojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të një llogarie bazike të transaksionit me pak ose aspak kosto për të gjithë individët dhe bizneset që nuk kanë një llogari. Për më tepër, ofrimi i llogarisë rrjedhëse dhe ofrimi i produkteve të pagesave mund të ketë nevojë të rishikohet në dritën e përmirësimit të dizajnit të përgjithshëm dhe përballueshmërisë së çmimit. Strategjitë e sektorit publik dhe atij privat duhet të përputhen me nevojat, zakonet dhe pengesat që hasen në zotërimin dhe përdorimin e llogarisë nga palët e pambuluara ose pak të mbuluara me shërbime bankare (si konsumatorë, ashtu dhe biznese), dhe të identifikojë zgjidhje me objektiva të matshëm. Inovacioni i teknologjisë dhe i modelit të biznesit ndihmon gjithëpranueshmërinë, lehtësinë për t'u përdorur dhe inkurajon barrierat më të ulëta të besimit. Paralelisht, nismat për aksesin dhe përdorimin duhet të plotësohen me iniciativa të mëtejshme për të rritur nivelin e kulturës financiare në Shqipëri.

Në terma të pikave të aksesit, gjatë periudhës 2015-2016, norma e rritjes neto të degëve të bankave dhe ATM-ve për 100,000 të rritur ishte negative (përkatësisht me -4.2% dhe -3.2%), ndërkohë që norma e rritjes neto për agjentët e parasë elektronike dhe терминаlet POS ishte pozitive (përkatësisht +25.7% dhe +6.3%).

Konsumatorët shqiptarë raportojnë se dërgojnë dhe marrin pagesa ditore në shumicën dërrmuese në cash (96% e pagesave të iniciuara, në krahasim me 90% të pagesave të marra). Të gjitha ndërmarrjet/bizneset e

2. Të dhënat e fundit Index (Demirgüç-Kunt et al. 2018) tregojnë se aksesin në llogaritë bankare për të rriturit në Shqipëri ka arritur në 40%.

anketuara, raportojnë se 99.2% e të gjitha pagesave në terma vëllimi janë pranuar në *cash*, kundrejt 66% të pagesave të iniciuara. Bizneset që pranojnë pagesa elektronike përmes një pajisjeje POS janë të kufizuara në 15% të atyre të vrojtuar. Zbatimi i planifikuar i debitimit direkt ndërbankar pritet të kontribuojë në shërbime me kosto më të efektshme/ulëta të pagesave të faturave dhe në përdorim më të ulët të *cash*-it ndërmjet konsumatorëve dhe bizneseve. Gjithashtu, produktet e parasë elektronike po tregojnë potencial në këtë drejtim.

Anketimet e kahut të kërkesës, sugjerojnë se pagesat në *cash* janë të përqendruara në pikën e bashkëveprimit³, dhe për blerjen e mallrave ushqimore dhe të domoshme. Megjithatë, edhe kanale të tjera shërbimi dhe përdorimi mbështeten gjerësisht në përdorimin e *cash*-it. Pas pagesave për mallra ushqimore dhe të domoshme, shqiptarët kryejnë shumicën e pagesave për faturat utilitare/të shërbimeve periodike të ndryshme; nga këto, 90% kryhen në *cash*. Gjithashtu, 95% e transferave individ-me-individ kryhen në *cash*. Edhe pse disburimet e qeverisë paguhen në një masë të madhe drejtpërsëdrejti në llogarinë bankare të përfituesit, pensionet e pensionistëve kanalizohen në shumicën e rasteve në kanale shërbimi fizike dhe paguhen në *cash*.

Aktivitetet vjetore të hyrje-daljes së *cash*-it janë gjithashtu të rëndësishme për Shqipërinë, siç paraqitet edhe në gjetjet e raportit. Në vitin 2016, kanë ndodhur rreth 22.5 milionë tërheqje *cash*-i në Shqipëri, nga të cilat 59% nëpërmjet kartave të debitit në ATM, dhe 32% në degët e bankave. Një tjetër formë e tërheqjeve *cash* përfaqësohet nga dalja e *cash*-it tek një agjent i parasë elektronike, me 19%. Për më tepër, janë vendosur afërsisht 10.5 milionë depozita në *cash*, 85% e të cilave në degët e bankave, dhe 15% tek agjentët e parasë elektronike.

Raporti sugjeron se stimujt qeveritarë dhe të industrisë (p.sh. stimujt fiskalë, monetarë, por edhe modelet inovative të biznesit të mbështetura në teknologji) mund të jenë të dobishme për rritjen e pranimit të pagesave elektronike në pikën e ndërveprimit. Në këtë kontekst, përpjekjet për të luftuar informalitetin do të jenë gjithashtu të rëndësishme në përshtetimin e kallimit tek pagesat elektronike në pikën e shitjes, duke qenë se informaliteti dhe *cash*-i kanë një marrëdhënie simbozë. Zgjerimi i rrjetit të bankingut përmes internetit/celularit (mobile banking) dhe shfrytëzimi i parave elektronike për pagesa të faturave është kritike për të frenuar metodat e tjera të kushteshme të transmetimit të instrumenteve të page-

save në *cash* dhe në formë letër (p.sh. zyra e pagesave).

Ndërmjet instrumenteve të pagesave jo-*cash* të procesuara gjatë vitit 2016, transferat e kreditit tejkaluan gjithë instrumentet e tjera bazuar në vëllim. Numri i transferave të kreditit arriti rreth 7.7 milionë, nga të cilat 77% ishin në formë letër dhe 23% në formë elektronike. Instrumenti i dytë elektronik i pagesave më i përdorur, është karta e debitit, me 1.9 milionë transaksione, nga të cilat 94% të kryera në pikat e shitjes POS, dhe 6% nëpërmjet internetit. Pagesat me karta krediti e ndjekin nga afër me 1.2 milionë pagesa. Në krahasim me kartat e debitit, kartat e kreditit përdoren më shumë për pagesa online (56%) sesa në pikat e shitjes POS (44%). Në vitin 2016, janë procesuar 0.7 milionë transaksione debitimi direkt (90% në formë letër dhe 10% elektronikisht) dhe 0.3 milionë transaksione me para elektronike (92% nëpërmjet rrjetit të telefonisë celulare dhe 8% nëpërmjet internetit).

Për përdorimin aktual të instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël, aktorët e kahut të kërkesës (konsumatorët, bizneset dhe agjencitë qeveritare) përballen me kosto vjetore të barabartë me 1.6% të PBB-së së Shqipërisë, ndërkohë që vetëm kostoja e *cash*-it është rreth 1% dhe konsumatorët mbartin peshën më të madhe të saj. Megjithatë, bazuar në koston e një transaksioni, transferat e kreditit në formë letër janë instrumenti i pagesës më i shtrenjtë për kategoritë e përdoruesve, ndjekur vetëm nga *cash*-i. Kostoja vjetore totale e instrumenteve të e pagesave elektronike llogaritet në më pak se 0.35% të PBB-së. Për më tepër, analiza tregon se kanalet e shërbimit që lidhen më ngushtë me përdorimin e *cash*-it dhe instrumente të tjera pagese në formë letër (p.sh. zyrat e pagesës, dega e agjentëve dhe degët e bankave) janë më të kushtueshmet për përdoruesit si rezultat i kohës së shpenzuar për të arritur në vendndodhjen e shërbimit, kohës së pritjes në radhë dhe kryerjes së transaksionit, krahasuar me kanale të tjera shërbimesh si p.sh. interneti.

Vëllimet e pagesave në *cash* të kryera në degën e bankës kombinuar me koston relative të degës së bankës, si një metodë transmetimi, sugjerojnë se klientët e bankës mund të përfitojnë nga zbatimi i modeleve të agjentëve nga ana e bankave, duke ulur kështu kostot e bazuara në kohë, sidomos në zonat rurale, dhe ndoshta duke lehtësuar gjithashtu pengesat si kulturore dhe ato të besimit.

3. Pika ku takohen paguesi dhe përfituesi (zakonisht pika e shitjes).

Kostoja vjetore që mbartet nga ana e aktorëve të kahut të ofertës në ofrimin e shërbimeve të pagesave me vlerë të vogël, arrin në 1.31% të PBB-së. *Cash*-i qëndron sërish si një nga instrumentet e pagesave me kosto më të lartë në baza totale, përkatësisht në 0.65% të PBB-së. Kostot e kartave të debitit e pasojnë dhe janë pak më të larta se kostot e kartave të kreditit, që kryesisht vijnë nga një volum më i lartë, pastaj vijnë transfertat e kreditit, debitimet direkte dhe paraja elektronike. Ashtu si edhe në rastin e kahut të kërkesës, bazuar në një transaksion, transfertat e kreditit në formë letër dhe debitimi direkt në mënyrë elektronike, si dhe transfertat elektronike të kreditit kushtojnë më shumë nga të gjitha instrumentet e tjera të pagesave, të pasuara nga kostot e depozitimeve/tërheqjes së *cash*-it. Të gjitha transaksionet elektronike janë më pak të kushtueshme se sa ekuivalentet e tyre në formë letër, me transfertat elektronike të debitimit direkt dhe transfertat elektronike të kreditit, më pak të kushtueshme nga të gjitha. Tregues të tjerë të rëndësishëm të koston së industrisë, të nxjerra në analizë përfshijnë koston mesatare vjetore të mirëmbajtjes së një terminali fizik POS 12,044 lekë (\$103.6), kostoja mesatare vjetore e mirëmbajtjes së një ATM jashtë ambientit të institucionit, 475,000 lekë (\$4,085) dhe kostoja mesatare vjetore e mbajtjes së një agjenti 126,600 lekë (\$1,084).

Procesimi i kartave lokale, në rrethana të caktuara, mund të kontribuojë në zvogëllimin e disa prej këtyre kostove, të cilat janë operacionalisht strategjike për bankat (duke pasur parasysh rritjen e transaksioneve me kartat e pagesave) dhe sistemin e pagesave në tërësi (p.sh. si rezultat i qeverisjes lokale dhe vendimmarrjes).

Në nivelin e ekonomisë, ku kombinohet kahu i kërkesës dhe i ofertës dhe ku konsiderohen vetëm kostot e burimeve, *cash*-i mbetet instrumenti më i kushtueshëm i

pagesës në 1.7% të PBB-së. Pagesat me karta pasojnë me 0.22% për kartat e kreditit dhe 0.21% për kartat e debitit. Kostot që lidhen me transfertat e kreditit në formë letër arrijnë në 0.20% të PBB-së, ndërsa të marra së bashku transfertat elektronike të kreditit, debitimet direkte, paraja elektronike dhe paratë në internet mbarin 0.17%. Nga të gjitha kostot e pagesave në formë letër, 50% përballohen nga konsumatorët, 25% nga bizneset, 24% nga ofruesit e shërbimeve të pagesave/infrastrukturës dhe 1% nga agjencitë qeveritare. Përsa i përket instrumenteve të pagesave elektronike, rreth 55% e kostove lidhet me ofruesit e shërbimeve të pagesave/ofruesit e infrastrukturës, 30% është e lidhur me konsumatorët, 14% është e lidhur me bizneset dhe 1% me agjencitë qeveritare.

Studimi arrin në përfundimin se kursimet për deri në 0.9% të PBB-së ose pothuajse gjysma e të gjitha kostove të instrumenteve të pagesave në formë letër mund të arrihen në ekonominë shqiptare duke zëvendësuar pagesat në formë letër me instrumente elektronike të pagesave. Kur rastet specifike të përdorimit konsiderohen në kontekstin e sistemit të pagesave në Shqipëri, një zëvendësim prej 50% të pensioneve nga *cash* në transfera krediti elektronike do të gjeneronte kursime vjetore prej 385 milionë lekësh (\$3.3 milionë) për pensionistët, 350 milionë lekë për qeverinë (\$3 milionë) dhe 500 milionë lekë (\$4.3 milionë) për ofruesit e shërbimeve të pagesave/infrastrukturës. Në mënyrë të ngjashme, nëse 50% e pagesave të faturave në *cash* zëvendësohen me debitime elektronike direkte, konsumatorët do të kursenin rreth 750 milionë lekë (\$6.5 milionë), bizneset do të kursenin rreth 1 miliard lekë (\$8.2 milionë), ndërsa ofruesit e pagesave/infrastrukturës me përafërsisht 1.8 miliardë lekë (\$15.5 milionë).

I. METODOLOGJIA⁴

Përdoruesit e shërbimeve të pagesave përbëjnë kahun e kërkesës së aktorëve të pagesave me vlerë të vogël. Përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU) mund të kategorizohen gjerësisht në konsumatorë (mund të përdoret gjithashtu edhe termi "familje", "individë" ose "person"), biznese (ndërmarrje të regjistruara, duke përfshirë shitësit me pakicë, pronarët e vetëm (sole proprietorships) dhe ofruesit e vetëpunësuar të mallrave dhe shërbimeve), dhe agjenci qeveritare (qendrore, rajonale dhe lokale/vendore). Të gjitha këto zakonisht kanë një rol të dyfishtë, duke qenë pagues për disa transaksione pagese të caktuara dhe përfitues për të tjerat.

Ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) dhe ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) përbëjnë kahun e ofertës së zinxhirit të vlerave të pagesave. Ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) emetojnë instrumente pagesash (p.sh. *cash*, karta pagesash, para elektronike) për përdoruesit e shërbimit të pagesave (PSU)/kahut të kërkesës dhe/ose ofrojnë shërbime, të cilat lejojnë përdoruesit të iniciojnë pagesa me vlerë të vogël me një instrument të caktuar pagese, duke përfshirë shërbimet mbështetëse/ndihmëse (p.sh. hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive të transaksioneve). Një bankë qendrore zakonisht është emetues i kartëmonedhave dhe monedhave, ndërkohë që bankat tregtare, institucionet financiare të mikrokredisë, institucionet e parasë elektronike dhe ofrues të tjerë të shërbimeve të pagesave jobanka janë emetues të instrumenteve të pagesave *jo-cash* (përfshirë këtu instrumentet e pagesave elektronike).

Tabela 1: Llojet e pagesave me vlerë të vogël

PAGUESI	PËRFITUESI		
	Konsumator	Biznes	AGJENCI QEVERITARE
Konsumator	P2P	P2B	P2G
Biznes	B2P	B2B	B2G
Agjenci qeveritare	G2P	G2B	G2G ⁵

Shënim: B2B = biznes për biznes, B2G = biznes për qeverinë, B2P = biznes për person, G2B = qeveria për biznes, G2G = qeveria ndaj qeverisë, G2P = qeveria për person, P2B = person për biznes, P2G = person për qeveri, dhe P2P = person për person.

- Për një lexim më të thellë të kuadrit të përgjithshëm metodologjik, ju lutem shikoni "A Practical Guide for Measuring Retail Payment Costs".
- Pagesat G2G (qeveri për qeveri) do të konsiderohen vetëm në kontekstin e veprimtarive dytësore siç janë pranimet në cash dhe çeket, furnizimi me monedha (supply of change) dhe transferimi i fondeve nëpërmjet llogarive të veta.

Përveç ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) që emetojnë instrumente të pagesës dhe (në rastin e pagesave *jo-cash*) zakonisht mirëmbajnë llogaritë e transaksioneve, ka institucione të cilat ofrojnë shërbime transaksionesh hyrje dhe dalje *cash*-i (*cash-in/cash-out*) (p.sh. operatorët e transferimit të parave) ose funksione shtesë (p.sh. zyrat e këmbimit valutor nëse monedha e huaj luan një rol të konsiderueshëm në sistemin e pagesave me vlerë të vogël të një vendi). Nga ana tjetër, ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) ofrojnë shërbime të infrastrukturës së pagesave zakonisht tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) dhe jo drejtpërdrejt tek përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU). Shërbimet tipike të ofruara nga ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) përfshijnë shërbime logjistike të *cash*-it ose (për pagesat *jo-cash*) autorizimin, *switching*/kallimin, klerimin dhe shërbimet e netimit dhe/ose shlyerjes⁶.

Përdorimi dhe ofrimi i shërbimeve të pagesave gjeneron kosto për aktorët e përfshirë, si p.sh. për përdoruesit e shërbimeve të pagesave (PSU) dhe/ose ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP). Ndërkohë që ka disa mënyra për të klasifikuar kostot, theksi është vënë këtu në zbatimin praktik të klasifikimit. Dy kategoritë vlijuese të kostove që konsiderohen janë: (i) natyra (burimi përkundrejt transferimit), dhe (ii) ndryshueshmëria (fikse përkundrejt variabël). Këto lloj kostosh janë të dallueshme brenda kategorisë, por jo ekskluzivisht ndërmjet kategorive, dhe nuk ekziston asnjë lidhje e veçantë midis tyre. Kjo nënkupton se, një element kostoje që është klasifikuar si burim (ose transferim) mund të jetë ose fikse ose variabël.

Shumica e të dhënave të kostos përfshijnë kostot variabël dhe mund të alokohen paraprakisht në transaksionet e vetme (p.sh. koha e transaksionit). Megjithatë, të dhënat për disa elemente kostoje merren për perludhën (p.sh. në baza javore, mujore ose vjetore) sesa në bazë të një transaksioni. Këto janë kryesisht kostot fikse si tarifrat që lidhen me llogarinë e transaksionit dhe/ose instrumentet e pagesave. Megjithatë, pas analizës së të dhënave, këto elemente kostoje janë shpërndarë në transaksionet e vetme të pagesave duke përdorur vëllimin e transaksionit si çelësin kryesor të shpërndarjes, me qëllim krijimin e një baze të përbashkët.

- Është e rëndësishme të theksohet se metodologjia e tanishme ndjek një metodë funksionale dhe jo një qasje institucionale kur identifikon dhe mat shpenzimet që lidhen me ofruesit e shërbimeve të pagesave/ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PSP/PIP). Në varësi të kushteve të tregut, një institucion mund të kategorizohet në ofrues të shërbimit të pagesave (PSP) si dhe në kategorinë e ofruesit të infrastrukturës së pagesave (PIP). Një shembull tipik i kësaj do të ishte bankat qendrore, të cilat në shumë vende jo vetëm emetojnë vlera monetare/para (një funksion i ofruesit të shërbimit të pagesave - PSP), por gjithashtu ofrojnë shlyerje pagesash dhe nganjëherë edhe shërbime të *switching*/ kallimit, klerimit dhe netimit të pagesave (funksionet ofruesit të infrastrukturës së pagesave - PIP).

Figura 1: Metodatat treguese të transmetimit



Metodologjia analizon/shqyrton transaksionet e pagesave në kontekstin e përgjithshëm të përdorimit të tyre duke përfshirë faktorë të rëndësishëm (p.sh. llojin e pagesës, metodën e transmetimit dhe rastin e përdorimit), që kanë të ngjarë të ndikojnë në kostot e pagesave me vlerë të vogël. Metoda e transmetimit të pagesës tregon si iniciohet dhe/ose merret një pagesë. Dy kategoritë kryesore të metodave të transmetimit janë pagesa në person (p.sh. pika e ndërveprimit, ATM, dega e bankës, zyra e pagesës, agjenti) dhe pagesa në distancë (remote) (p.sh. interneti, rrjeti i telefonit/telefoni celular). Raste të ndryshme të përdorimit konsiderohen gjithashtu në kontekstin e konsumatorëve (p.sh. remitancat, pagesat për mallra/shërbime, pagesat për fatura periodike, pagat, pensionet, ndihmat sociale etj.).

Metodologjia ofron njohuri mbi kursimet që mund të lindin kur kalohet/migrohet nga pagesat në formë letër në përpunimin elektronik të pagesave. Është e mundur të merret në konsideratë një numër skenarësh të ndryshëm zëvendësimi (si p.sh. 35%, 70% dhe 100% përqindje konvertimi). Kursimet në secilin skenar tregohen duke përdorur shifrat totale vjetore të kostos dhe duke marrë parasysh disa parashikime të reduktimit që rezultojnë nga kalimi nga një instrument pagese (p.sh. transfertë krediti në formë letër) në një tjetër (p.sh. transfertë krediti elektronike/në formë jole tër ose para elektronike).

Duke pasur parasysh që vrojtimet janë kryer në periudha kohore të ndryshme, analiza e kahut të kërkesës portretizon gjetje të cilat i takojnë vitit kalendarik 2014, ndërkohë që analiza e kahut të ofertës portretizon gjetje që i takojnë vitit kalendarik 2016.

Për më tepër, jo të gjitha instrumentet e pagesave janë të përshtatshme për të gjithë aktorët e analizuar. Në mënyrë të veçantë, për konsumatorët, analizohen instrumentet në vijim: *cash*-i; transfertat e kreditit në formë letër (ndërbankare dhe intrabankare); kartë debiti; kartë krediti; transfertat e kreditit në formë jole tër/elektronike (ndërbankare dhe intrabankare); para elektronike. Për bizneset, analizohen instrumentet e mëposhtme: *cash*-i; transfertat e kreditit në formë letër (ndërbankare dhe intrabankare); kartë debiti; kartë krediti; transfertat e kreditit në formë jole tër/elektronike (interbankare dhe intrabankare); debitimi direkt elektronik (intrabank). Për agjencitë qeveritare, analizohen instrumentet e mëposhtme: *cash*-i; transfertat e kreditit në formë letër (ndërbankare dhe intrabankare); transfertat e kreditit në formë jole tër/elektronike (ndërbankare dhe intrabankare). Për ofruesit e shërbimeve të pagesave dhe të infrastrukturës së pagesave (PSP/PIP), shqyrtohen instrumentet në vijim: *cash*-i; transfertat e kreditit në formë letër (ndërbankare dhe intrabankare); debitimi direkt në formë letër (intrabank); kartë debiti; kartë krediti; transfertat e kreditit në formë jole tër/elektronike (interbank dhe intrabank); debitimi direkt elektronik (intrabank); para elektronike.

Hapësira Informuese 1.

Administrimi i anketimit për palët e ndryshme të interesit*

Konsumatorët: Sondazhet e intervistimit të konsumatorëve ballë për ballë janë kryer nga INSTAT-i në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe Grupin e Bankës Botërore me qëllim mbledhjen e të dhënave kryesore të konsumatorit. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ishte 30 minuta. Kuadri i kampionit u bazua në të dhëna përmbledhëse për zonat e regjistrimit (EAs) të përcaktuara në Censusin e vitit 2011 të Shqipërisë për Regjistrimin e Popullsisë dhe Strehimit. Disponueshmëria e një kuadri relativisht të kohëve të fundit të marrjes së kampioneve siguroi që të mund të zgjidhej një kampion efektiv dhe përfaqësues për pyetësoin. Së fundi, 897 të rritur iu përgjigjën pyetësorit në vendin e tyre të banimit. Në përgjithësi, kampioni final përbëhej nga 50.2% e të intervistuarve në zona rurale dhe 49.8% e të intervistuarve në zona urbane. Gjendet një shpërndarje e barabartë në shumicën e kategorive për karakteristikat e ndryshme socio-demografike brenda kampionit.

Bizneset: Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) u përdor si bazë për kornizën e kampionit të anketës së biznesit. INSTAT-i mirëmban regjistrin që nga mesi i viteve 1990. Për përzgjedhjen e kampionit u përdor teknika e kampionit të stratifikuar, me një madhësi përfundimtare prej 716 biznese. Shtresa e këtij kampioni u bazua në gjashtë sektorë ekonomikë (bujqësi, industri, ndërtim, tregti, transport dhe shërbime) dhe katër kategori të madhësive të biznesit (mikro-biznese, ndërmarrje të vogla, të mesme dhe të mëdha). Nisur nga rëndësia e Tiranës si qendra kryesore ekonomike e vendit, rreth 50% e kompanive në kampionin e përdorur ishin të vendosura në kryeqytet. Prej 716 bizneseve të përzgjedhura për t'u intervistuar, 104 refuzuan të merrnin pjesë, ndërsa 150 biznese u mbyllën, nuk u gjetën, ose nuk mund të krijohej asnjë kontakt. Bizneset që u përgjigjën vinin nga të gjashtë sektorët ekonomikë, ku më të mëdhatë ishin tregtia dhe prodhimi. Përsa i përket gjeografisë, bizneset e përgjigjura shpërndahen në 27 qytete, duke mbuluar të 12 qarqet administrative të Shqipërisë.

Agjencitë qeveritare: Ato mund të ndahen në tri kategori kryesore: agjenci të qeverisë qendrore; institucione të qeverisjes vendore; kompani të shërbimeve publike.

Studimi përfshin të gjitha ministrinë dhe agjencitë kryesore të qeverisë qendrore. Përsa i përket pagesave të qeverive vendore, studimi është përqendruar kryesisht në Bashkinë e Tiranës për shkak të rëndësisë së saj në drejtim të përqendrimit të popullsisë dhe aktivitetit të biznesit. Në mënyrë të veçantë, Tirana përfaqëson rreth 30% të popullsisë së Shqipërisë, ndërsa në aspektin e aktivitetit ekonomik, bizneset që operojnë në Tiranë përbëjnë gati 45% të të gjitha bizneseve në vend. Përsa i përket pagesave të shërbimeve publike, si në rastin e pagesave të qeverive vendore, studimi gjithashtu fokusohet në pagesat e faturave të ujit në kryeqytet.

Ofruesit e Shërbimeve të Pagesave (PSP)/ Ofruesit e Infrastrukturës së Pagesave (PIP): Përsa i përket kahut të ofertës së tregut të pagesave në Shqipëri, nuk është përdorur asnjë teknikë e kampionit për shkak të numrit të vogël të aktorëve ofrues në treg. Të dhënat u grumbulluan nga: të 16 bankat tregtare që veprojnë në Shqipëri; Banka e Shqipërisë (në rolin e Ofruesit të Shërbimeve të Pagesave – PSP si emetues i monedhës dhe në rolin e saj të Ofruesit të Infrastrukturës së Pagesave-PIP si operator i sistemit të kleringut të automatizuar dhe sistemit të shlyerjes bruto në kohë reale); 2 emetues të parasë elektronike; 1 operator i transferimit të parave; 1 iniciator i pagesave të faturave. Në janar 2017 u mbajt në Tiranë, një seminar njëditor në partneritet me Bankën e Shqipërisë, ku ishin të pranishëm të gjithë pjesëmarrësit e anketës në mënyrë që të njiheshin me objektivat dhe strukturën e pyetësorëve të anketës. Pas seminarit, pyetësorët e personalizuar u dërguan në mënyrë elektronike në secilin institucion pjesëmarrës. Të anketuarve iu dha një muaj kohë për të plotësuar pyetësorët (duke pasur parasysh se të dhënat duhej të mblidheshin së bashku nga departamente të ndryshme) dhe t'i kthejnë ato në Bankën e Shqipërisë dhe në Bankën Botërore. Çështjet që dolën gjatë asaj periudhe u adresuan nga ekspertët e Bankës së Shqipërisë dhe të Bankës Botërore. Kjo u ndoq me kontrollin e cilësisë së të dhënave, ku në disa raste kërkohet informacion shtesë dhe sqarime nga institucionet përgjegjëse, veçanërisht aty ku u zbuluan mospërputhje dhe gabime.

* Duhet të theksohet se edhe pse disa nga pyetjet e këtij anketimi të konsumatorit janë të ngjashme me Findex, duke qenë se mbulojnë aspekte të përfshirjes financiare, struktura dhe objektivi i përgjithshëm janë të ndryshme, pasi qëllimi kryesor i këtij anketimi është matja e kostove dhe kursimeve që lidhen me pagesat me vlerë të vogël.

II. ZOTËRIMI DHE PËRDORIMI I LLOGARIVE TË TRANSAKSIONEVE DHE INSTRUMENTEVE ELEKTRONIKE TË PAGESAVE

Në kohën e pyetësorit të kahut të kërkesës (viti 2014), 38.5% e të rriturve shqiptarë kishin akses në një llogari bankare⁷, me rreth 33.5% që kishin një llogari personale dhe 5% të cilët aksesonin një llogari nëpërmjet një pjesëtari familjeje. Meqë produktet e parasë elektronike nuk ishin ende në dispozicion por që shiheshin si diçka që parashikohej të bëheshin të disponueshme në të ardhmen e afërt, pyetësori përfshinte aksesin në paranë në internet (PayPal) si një përfaqësuese të tyre; që nga viti 2014, 0.5% e popullatës shqiptare, kishte akses në paranë në internet/elektronike. Zotërimi i llogarive bankare bie në 23% të popullsisë së rritur në zonat rurale, krahasuar me 50% në zonat urbane. Në të gjitha kategoritë e moshave, të rriturit 65 vjeç e lart duket se shfaqin raportin më të ulët për aksesin në llogarinë bankare (20%), krahasuar me moshat 40-64 vjeç (45%) dhe 18 deri 39 vjeç (39%). Vetëm 2% e popullsisë raportuan përdorimin e Internet banking të paktën një herë gjatë gjashtë muajve të fundit.

Bazuar në gjetjet e pyetësorit, 24% e popullatës së rritur në Shqipëri, zotëron një kartë debiti dhe 3.5% zotëron një kartë krediti. Raporti më i lartë i zotërimit së kartave të debitit është vërejtur për moshat midis 30 dhe 39 vjeç (32%). Kategoritë e tjera të moshave shfaqin raporte të ngjashme të zotërimit të kartave të debitit, me përjashtim të atyre të moshës 65 vjeç e lart, me një raport të zotërimit prej vetëm 7%.

Mbi 75% e mbajtësve të kartave të debitit kanë raportuar që e përdorin kartën e tyre vetëm për tërheqje *cash*-i. Kjo gjetje është e mbështetur në të dhënat e

7. Përcaktuar si një llogari e mbajtur në bankat tregtare private që mundëson përdoruesin të vendosë depozita dhe të iniciojë/marrë pagesa.

kahut të ofertës për vitin 2014, sipas së cilës mesatarisht mbajtësi i një karte debiti ka kryer afërsisht 14.9 tërheqje *cash*-i në ATM, 1.5 pagesa me kartë debiti në pikat POS, dhe 0.04 pagesa me kartë debiti nëpërmjet Internetit. Në vitin 2016, numrat ekuivalentë të tyre janë 15.2 për tërheqje *cash*-i nga ATM, 2.1 për pagesa me kartë debiti në pikat POS, dhe 0.1 për pagesa me karta debiti nëpërmjet Internetit⁸.

Modell për kartat e kreditit është i ndryshëm nga kartat e debitit, duke qenë se raportet e përdorimit në të gjitha metodat e transmetimit nuk ndryshojnë aq shumë. Në vitin 2014, siç tregohet në të dhënat e kahut të ofertës, mbajtësi i zakonshëm i kartës së kreditit ka bërë 8.9 tërheqje *cash* nga ATM, 8.3 pagesa me kartë krediti në internet dhe rreth 4 pagesa me kartë në POS. Në vitin 2016, shifrat ishin 11.3 për tërheqje *cash*, 8.2 për pagesat në internet dhe 6.3 për pagesat në POS.

Kartat me parapagim janë në fillimet e tyre dhe përdoren më shpesh për tërheqje sesa në vend të pagesave, megjithëse kjo qasje po ndryshon. Në vitin 2014, mbajtësi i kartave me parapagesë bëri 0.8 tërheqje *cash* dhe 0.04 pagesa në POS, ndërsa në vitin 2016 kishte 0.9 tërheqje *cash* dhe 0.1 pagesa në POS. Për më tepër, kartat me parapagim në qarkullim në vitin 2016 arritën në rreth 42,000, ndërsa llogaritë e parave elektronike në Shqipëri arritën në 177,000 në vitin 2016.

Shumica dërmuese (92%) e bizneseve të anketuara në Shqipëri kanë akses në një llogari bankare, edhe pse zotërimi i llogarisë ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në bazë të madhësisë së biznesit si dhe pranimi i

8. Për të nxjerrë krahasime të tilla, përdoret raporti i shfrytëzimit/përdorimit. Raporti i shfrytëzimit, në përgjithësi, përcaktohet si: numri i pagesave të iniciuara duke përdorur një kartë pagese në kanalin e transmetimit A gjatë periudhës B / numri i kartave të pagesave në qarkullim gjatë periudhës B. Raportet e shfrytëzimit rrjedhin për secilën prej tre kartave të pagesave për përdorim në POS, internet dhe ATM, me kalimin e kohës. Në thelb ky tregues tregon numrin e pagesave / transaksioneve që mbajtësi i kartës bën mesatarisht gjatë një periudhe kohore (zakonisht një vit).

Tabela 2: Raportet e përdorimit për kartat e pagesave ndër vite

VITI	KARTAT E DEBITIT			KARTAT E KREDITIT			KARTAT E PARAPAGUARA	
	ATM	POS	INTERNET	ATM	POS	INTERNET	ATM	POS
2014	14.85	1.52	0.04	8.92	4.06	8.29	0.82	0.04
2015	14.89	1.73	0.07	9.86	4.72	7.46	1.05	0.08
2016	15.25	2.10	0.14	11.34	6.34	8.19	0.88	0.10

pagesave elektronike nga tregtarët paraqitet i kufizuar. 40% e mikrobizneseve raportojnë se nuk zotërojnë një llogari bankare, krahasuar me 1% ose më pak të bizneseve të vogla / të mesme / të mëdha. Shumica e bizneseve të mesme dhe të mëdha (më shumë se 70%) raportojnë se zotërojnë tre ose më shumë llogari bankare. Në përgjithësi pak më shumë se gjysma e kampionit total të biznesit përdorin internet banking, ku majtën më të lartë me 62% e arrijnë bizneset e mëdha. Vetëm 2% e mikro-ndërmarrjeve dhe 14% e bizneseve të vogla⁹ raportuan se kishin një terminal POS. Tregtia online ofrohet rrallë - me më pak se 10% në të gjitha madhësitë e biznesit.

III. PIKAT E AKSESIT

Nga kahu i ofertës, analiza jep të dhëna në seri kohore (vitet 2014-2016) për disa tregues të infrastrukturës së pagesave për Shqipërinë. Gjatë këtij studimi, degët e bankave i referohen degëve të bankave tregtare, ndërsa agjentët (degët) i referohen vendndodhjeve fizike të lidhura me emetuesit/operatorët e parave elektronike. Terminalët POS janë specifikuar qëllimisht si terminale fizike për t'i dalluar ato nga terminalët virtuale POS¹⁰, të cilat ekzistojnë por janë shumë të kufizuara në Shqipëri (21 për 2014, 30 për 2015, 28 për 2016). Duhet të theksohet se institucionet e parasë elektronike, u licencuan nga Banka e Shqipërisë për herë të parë në vitin 2015; prandaj nuk ka statistika të parasë elektronike për vitin 2014. Gjithashtu vlen të përmendet se përveç numrit absolut të pikave të aksesit të analizuara gjatë kohës, është matur edhe numri i pikave të aksesit për 100,000 të rritur, si dhe normat e rritjes për 100,000 të rritur, për krahasime më kuptimplota/me vlerë¹¹.

Rënia e normës neto të rritjes¹² për degët e bankave dhe ATM-ve është një sinjal i qartë se bankat tregtare janë duke u larguar nga pikat fizike të aksesit dhe po shkojnë drejt pikave të aksesit të në distancë dhe kjo në të njëjtën kohë vjen edhe si pasojë e ngadalësimit të fundit ekonomik. Ndërsa numri i degëve të bankave (për 100,000 të rritur) u rrit me 9.1% gjatë periudhës 2014-2015, ai zbriti me 4.2% për 2015-2016. Kjo është e rëndësishme, sidomos kur merret parasysh modeli i ngjashëm i ATM-ve (për 100,000 të rritur), i cili u rrit me 3% gjatë 2014-2015 dhe më pas u zvogëluar me 3.2%.

Ndryshe nga degët e bankave dhe ATM-të, numri i pikave/degëve të agjentëve dhe terminaleve POS (për 100,000 të rritur) ka pësuar rritje në Shqipëri. Numri i pikave të agjentëve është rritur me 27.5% gjatë dy viteve të fundit. Prania e agjentëve është e rëndësishme për qëllimet e përfshirjes financiare, duke pasur parasysh se ato kanë tendencë të mbulojnë edhe zona të largëta. Në të njëjtën kohë, shpërndarja e pikave të agjentëve shoqërohet me një numër të madh procesesh të hyrje-daljes së *cash-it*, gjë që ngre shqetësime lidhur me efikasitetin e kostos. Përsa i përket terminaleve POS (për 100,000 të rritur), rritja neto e tyre ka pësuar rritje nga 4.4% (2014-2015) në 6.3% (2015-2016).

Kartat aktive¹³ të pagesave në qarkullim kanë shënuar një rritje pozitive për të gjitha llojet e kartave gjatë gjithë kohës, ndërkohë që normat e rritjes kanë pësuar rënie me përjashtim të kartave të parapaguara. Për kartat e debitit, norma e rritjes ka rënë nga 6.8% në 5%, ndërsa për kartat e kreditit është zvogëluar nga 10.4% në 5.5%. Zotërimi i tyre nuk nënkupton domosdoshmërisht përdorim, megjithatë rënia e ritmeve të rritjes së kartave aktive të debitit dhe të kreditit ende ngre shqetësime. Një faktor që shpjegon rënie është aksesit i ulët në llogaritë bankare, por arsye të tjera mund të hulumtohen më tej nga Banka e Shqipërisë. Kartat me parapagim tregojnë një tendencë rritjeje nga 21.4% në 26.5%.

9. Për qëllimet e këtij studimi në Shqipëri, mikro-bizneset dhe bizneset e vogla përkufizohen si ato që kanë përkatësisht 1 deri në 4, dhe 5 deri në 19 punonjës.

10. Një terminal virtual POS nënkupton terminalin (POS) të aksesueshëm nga interneti për kryerjen e pagesave me kartë debiti/kreditit. Është një aplikacion program/software që mbahet në internet, zakonisht në serverët e ofruesve të shërbimit dhe mund të arrihet nga çdo shfletues web-i i lidhur me internetin. Një terminal virtual lejon futjen e informacionit të kartës së klientit drejtpërdrejt në një formë të pagesës me bazë në internet, e cila pastaj mund të përdoret për të përpunuar një transaksion elektronik.


11. Kurdo që përdoret referencë për normat e rritjes në tekst në kontekstin e pikave të aksesit, ajo i referohet normave të rritjes së pikave të aksesit për 100,000 të rritur. Të dhënat e mëposhtme janë përdorur (nga INSTAT Demografi): popullsia e përgjithshme për vitin 2016 shënon 2,876,591, ndërkohë që popullsia e rritur (15 vjeç e lart) shënon 2,354,481; Popullsia e përgjithshme për vitin 2015 shënon 2,875,592, ndërkohë që popullsia e rritur shënon 2,343,985; Popullsia e përgjithshme për 2014 shënon 2,882,318, ndërkohë që popullsia e rritur shënon 2,348,649.

12. Niveli i rritjes neto merr në konsideratë pikat e aksesit të reja të krijuara dhe pikat e aksesit që janë mbyllur.


13. Kartat aktive të pagesës i referohen kartave të debitit dhe të kreditit të cilat janë marrë dhe aktivizuar nga përfutuesit e tyre.

Figura 2: Pikat e aksesit ndër vite

Numri i Pikave të Aksesit ndër vite (në terma absolutë)



Numri i Pikave të Aksesit ndër vite (për 100,000 të rritur)



Norma e Rritjes Neto të Pikave të Aksesit (për 100,000 të rritur) ndër vite





Figura 3: Kartat aktive të pagesave në qarkullim ndër vite



IV. KOSTOT E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL PËR AKTORËT DHE PËR EKONOMINË NË TËRËSI

Meqenëse kostot janë në funksion të vëllimit, ndër variablat e tjerë të kostos, secili aktor analizohet sipas vëllimit të transaksioneve, pasuar nga kostot që ai mbar¹⁴.

IV.1. KONSUMATORËT

Konsumatorët në Shqipëri kryejnë një total prej gati 127.5 milionë pagesash në vit (përmes instrumenteve të ndryshme të pagesave, rasteve të përdorimit dhe metodave të transmetimit) ose 53 pagesa për një të rritur në vit, nga të cilat 96% janë në *cash*. Transferrat direkte të kreditit në formë letër pasojnë me 2.2% të pagesave të iniciuara. Pagesat me kartë debiti dhe krediti llogariten me 0.6% secila, ndërsa transfertat elektronike të kreditit me 0.4% dhe paraja në internet me 0.2%. Megjithatë, numri i përgjithshëm i pagesave të iniciuara (veçanërisht përmes *cash*-it) ka gjasa të jetë i nënvlerësuar¹⁵.

14. Të dhënat pasqyrojnë përgjigjet e mbledhura nëpërmjet anketave dhe si të tilla, janë po aq të sakta sa përgjigjet.
15. Një numër faktorësh kontribuojnë në këtë rezultat. Së pari, në 57% të rasteve, i anketuari nuk është personi përgjegjës për financat e familjes (vetëm në 23% të kampionit personi përgjegjës është edhe kryefamiljari) dhe për këtë arsye ai/a jo nuk mund të jetë përgjegjës për pagesat me natyrë periodike (siç janë faturat e shërbimeve), duke rezultuar kështu me një numër më të vogël pagesash të iniciuara që raportohen. Arsyeja e dytë ka të bëjë me natyrën e pyetësorit, i cili mbështetet në vetë-raportimin e të anketuarit për numrin e pagesave. Me fjalë të tjera, të anketuarit përdorin perceptimet e tyre kur kujtojnë numrin e pagesave që ata bëjnë në një javë, muaj ose vit, dhe si të tilla, ata tentojnë të raportojnë një numër më të vogël se numri aktual, veçanërisht ato që lidhen me *cash*-in. Arsyeja e tretë lidhet me marrjen e kampionëve. Megjithëse kampioni është përfaqësues në nivel kombëtar, konsumatorët me numër përgjithësisht të ulët pagesash të iniciuara mund të jenë mbizgjedhur në kampion dhe anasjelltas, konsumatorët me nivele më të larta shpenzimesh mund të jenë nënzigjedhur, duke çuar në një numër të përgjithshëm të ulët pagesash të nisura në nivel kombëtar. Për shembull, individët me diplomë universitare dhe pasuniversitare, të cilët kanë tendencë të fitojnë më shumë dhe për këtë arsye iniciojnë më shumë pagesa, përbëjnë së bashku vetëm 15% të kampionit. Arsimi është një variabël i rastit, pra nuk kontrollohet.

Kur të dhënat analizohen sipas rastit të përdorimit, nuk është për t'u habitur që shumica e pagesave janë iniciuar për mallra ushqimore dhe të domosdoshme (64.5% ose 34.4 pagesa të tilla çdo vit për një të rritur). Pagesat për faturat dhe shërbimet periodike përbëjnë së bashku 30% të të gjitha pagesave, ndërsa pagesat për mallrat e qëndrueshme, pagesat e qeverisë dhe remitancat së bashku përbëjnë 5.5% të të gjitha pagesave të iniciuara vjetore.

Përsa i përket shpërndarjes sipas metodave të transmetimit, pagesat e iniciuara në pikën e ndërveprimit llogariten në 78.5%, ato në një degë të ofruesit të shërbimit të pagesave (PSP) me 11.5%, ndërkohë që 10% e pagesave të mbetura janë iniciuar në pikat e agjentëve, ose nëpërmjet internetit. Pagesat në internet përbëjnë vetëm 1.3% të të gjitha pagesave. Kur metodat e transmetimit priten me instrumentet e pagesave, rezultoni se 99% e të gjitha pagesave të iniciuara në pikën e ndërveprimit janë përmes *cash*-it. Një përqindje e mbetur iniciohet përmes kartës së debitit (0.7%) dhe kartës së kreditit (0.3%). Ndër të gjitha pagesat e degëve të bankave, 81% janë iniciuar përmes *cash*-it, ndërsa pjesa e mbetur prej 19% janë iniciuar nëpërmjet transfertave të kreditit në formë letër. Mes gjithë pagesave në internet, 35% janë iniciuar përmes transfertave elektronike të kreditit, 31% përmes kartës së debitit, 20% nëpërmjet kartës së debitit dhe 14% janë transaksione nëpërmjet internetit. Për më tepër, 10% e të gjitha pagesave të faturave iniciohen online.

Konsumatorët në Shqipëri marrin përafërsisht 38 milionë pagesa në vit ose 16 pagesa për çdo të rritur në vit, nga të cilat 90% janë pranuar në *cash*. Nga 10% i mbetur i pagesave që nuk pranohen në *cash*, 8% janë pranuar nëpërmjet transfertave direkte të kreditit¹⁶ dhe 2% nëpërmjet parasë në internet.

Përsa i përket shpërndarjes sipas rastit të përdorimit, shumica e pagesave merren për mallra dhe shërbime të ofruara për konsumatorët individualë, nga individë të tjerë që nuk janë biznese të formalizuara dhe që përbëjnë 28%. Pagat dhe pensionet vijojnë me 23% dhe 20% respektivisht, ndërsa remitancat llogariten në 15% dhe përfitimet e ndihmës sociale në 14%.

16. Nga ana pritëse, transfertat direkte të kreditit janë gjithmonë elektronike.

Kur analizohet fluksi i pagesave të marra sipas metodës së transmetimit, një pjesë e rëndësishme merret në pikën e ndërveprimit (29%), pasuar nga degët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) dhe ATM me 21%. Interneti, si kanali i vetëm ekskluziv *jo-cash*, përbën 10%¹⁷ të pagesave të marra, pikat e agjentëve 7% dhe zyrat pagesave 5%. Nëse rastet e përdorimit të konsumatorëve do të krahasohen me instrumentet e pagesave¹⁸, do të rezultonte se vetëm 5% e të gjitha remitancave (individ me individ) merren nëpërmjet Internetit.

Me përdorimin aktual të instrumenteve të pagesave siç përshkruhet më sipër, konsumatorët shqiptarë kanë një kosto ekonomike vjetore prej 1% të PBB-së¹⁹ së vendit për gjithë instrumentet e pagesave, ndërkohë që vetëm *cash*-i mbart 0.7% të PBB-së²⁰. Transfertat e kreditit në formë letër e pasojnë me 0.12% të PBB-së së vendit. Vlen të theksohet se këto kosto totale janë të nxitura nga një kosto e lartë për transaksion, ndërsa të tjerat vijnë nga një volum i lartë, ndërsa për *cash*-in vlejnë të dyja këto arsye.

Nuk është për t'u habitur që shumica dërrmuese e kostove që lidhen me përdorimin e instrumenteve në formë letër janë kosto oportune të bazuara në kohën e shpenzuar, për faktin se ato kërkojnë praninë fizike dhe udhëtimin e paguesit/përfituesit në pothuajse të gjitha rastet. Ngjashëm, pritet që shumica e kostove për instrumentet e pagesave elektronike të jenë kosto të drejtpërdrejta monetare që rrjedhin nga tarifat e ndryshme të vendosura. Përsa i përket transfertave të kreditit në formë letër, edhe pse një pjesë e konsiderueshme e kostove bazohen në kohën e shpenzuar, tarifat që lidhen me këtë instrument i tejkalojnë kostot e bazuara në kohën e shpenzuar, duke rezultuar në 90% të kostove të këtij lloji transfertash në kosto të drejtpërdrejta monetare.

Siç e tregon analiza, konsumatorët shqiptarë përballen me kostot më të larta totale kur shkojnë në degën e bankës (udhëtim), presin në radhë dhe kryejnë një transaksion. Megjithatë, duke u bazuar në kostot të cilat mbart udhëtimi për kryerjen e një transaksioni sipas pikave ku këto pagesave kryhen, metoda më e shtrenjtë e transmetimit të pagesave është zyra e pagesës, e ndjekur nga zyra e agjentit. Zyra e pagesave dëshmon koston më të lartë që lidhet me një procedurë arkëtimi të *cash*-it.

Duke kombinuar instrumentet e pagesave me metodat e transmetimit, kjo analizë zbulon se instrumentet e pagesave në formë letër, pavarësisht nga mënyra e transmetimit, janë më të kushtueshme sesa instrumentet elektronike të pagesave. Për pagesat e iniciuara, kombinimi më i kushtueshëm duket të jetë një transfertë krediti në formë letër në një degë të bankës, ndërsa më pak e kushtueshme është pagesa e kartës së debitit/kreditit në pikën e ndërveprimit. Vlen të përmendet se disa metoda transmetimi nuk i lejojnë pagesat me mjete elektronike (p.sh. zyrat e pagesave).

17. Duhet të përmendet se të gjitha pagesat e raportuara si të pranuar përmes një transfertë kreditimi janë të lidhura me metodën e transmetimit në internet. Megjithatë, pagesat të cilat dërgohen si transfertë direkte të kreditit nga paguesi, por janë marrë në formë *cash*-i nga përfituesi (p.sh. tërheqja e pagës ose pensionit që depozitohet në llogarinë e përfituesit në një degë të ofruesit të shërbimit të pagesave -PSP ose një ATM) llogariten si *cash*, dhe lidhen me metoda transmetimi të ndryshme nga interneti.

18. Në fakt, të dhënat nuk lejojnë një shfaqje të detajuar midis instrumenteve të pagesave dhe rasteve të përdorimit.

19. PBB-ja e vitit 2014.

20. PBB-ja e vitit 2014 për Shqipërinë u vlerësua në: 1.8 miliardë lekë ose \$14.5 miliardë.

Figura 4: Kostot vjetore për konsumatorët sipas instrumentit të pagesave si një përqindje e PBB-së për vitin 2014




Figura 5: Kostot për transaksion sipas instrumentit të pagesave në të gjitha metodat e transmetimit





Figura 6: Kostot për transaksion sipas metodës së transmetimit për instrumentet e pagesave



IV.2. BIZNESET

Bizneset shqiptare iniciojnë rreth 18,2 milionë pagesa në vit ose 792 pagesa për një biznes në vit, nga të cilat 66% në *cash*. Përdorimi i *cash*-it ndryshon sipas madhësisë së biznesit. Mikro-ndërmarrjet iniciojnë 93% të vëllimit vjetor të pagesave në *cash*, por kjo përqindje bie në 47% për bizneset e mëdha. Transferrat direkte të kreditit (si në formë letër dhe elektronike) ashtu edhe transfertat e debitimit direkt janë instrumentet më të përdorura, përkatësisht në vend të dytë dhe të tretë, pavarësisht nga madhësia e biznesit.

Në nivelin e përgjithshëm të biznesit, shumica e pagesave të iniciuara janë për blerjen e mallrave me pakicë dhe pajisjeve (37% e totalit të vëllimeve vjetore), 20% e totalit të pagesave të iniciuara nga bizneset përfaqësojnë paga, ndërkohë që faturat periodike përbëjnë 14%, sigurimi 13%, shërbimet 10% dhe pagesa të tjera, siç janë tatimet dhe detyrimet 6%. Rezulton që pika e ndërveprimit është metoda më e përdorur e transmetimit për pagesat e iniciuara nga biznesi (54%, nga të cilat shumica dërrmuese janë në *cash*), ndërsa pagesat përmes internetit dhe pagesat në degët e ofruesve të shërbimeve të pagesave (PSP) janë shpërndarë në mënyrë të barabartë (23% secila). Për më tepër, pak më shumë se gjysma e pagesave të tyre iniciohen në pikën e ndërveprimit: nga këto, shumica dërrmuese iniciohet me *cash* (pothuajse 97%), ndërsa pjesa tjetër me karta debiti dhe kreditit. Pagesat e iniciuara në një degë banke dhe nëpërmjet internetit kanë një shpërndarje të barabartë prej rreth 23%. Brenda një dege banke, *cash*-i përbën pak më shumë se transfertat e kreditit në formë letër (57% kundrejt 43%). Përsa i përket pagesave të iniciuara përmes internetit, transfertat elektronike të kreditit përbëjnë gjysmën e këtyre pagesave, pasuar nga debitimet direkte (27%), dhe pastaj pagesat me kartë krediti dhe debiti (përkatësisht 13% dhe 9%).

Në anën marrëse, bizneset në Shqipëri kanë pranuar 274 milionë pagesa çdo vit ose 2,543 pagesa për biznes në vit. Shumica dërrmuese e totalit të pagesave janë marrë

nga mikro-ndërmarrjet²¹. Nuk është për t'u habitur që 99% e të gjitha pagesave në biznese janë marrë në *cash*, duke pasur parasysh se 47% e kampionit të biznesit përbëhet nga mikro-ndërmarrje dhe biznese të vogla, të cilat: (i) tregojnë boshllëkun e madh në installimin e terminaleve POS, dhe njëkohësisht (ii) përbëjnë mbi 90% të të gjitha pagesave të marra nga të gjitha bizneset në Shqipëri. Kur zbërthehen vëllimet e marra sipas madhësisë së biznesit, del në pah se pagesat me karta debiti dhe krediti janë marrë nga të gjitha llojet e bizneseve, por zënë një pjesë më të madhe tek bizneset e mëdha. Siç pritej, transfertat elektronike të kreditit dhe transfertat e debitimit direkt nuk janë të rëndësishme për mikro-ndërmarrjet dhe bizneset e vogla, ndërkohë që ato përdoren më shumë në bizneset e mesme dhe të mëdha. Të dhënat gjithashtu tregojnë se pjesa më e madhe e të gjitha pagesave elektronike të pranuar nga bizneset përfaqësohet nga transfertat elektronike të kreditit, jo nga pagesat me karta, të cilat qëndrojnë në vendin e dytë.

Rasti i vetëm i rëndësishëm i përdorimit që konsiderohet në anën marrëse të pagesave të bizneseve është blerja e mallrave dhe shërbimeve. Një dallim është bërë bazuar në metodat e transmetimit, pikësisht ndërveprimit dhe internetit. Rrjedhimisht, shumica dërrmuese e pagesave për lloje të ndryshme të bizneseve janë marrë në pikën e ndërveprimit (99.6%), dhe në *cash* (99.5%). Kjo gjë pritej për shkak se tregtia në internet është mjaft e kufizuar në Shqipëri. Bizneset e mesme duket se kanë një pjesë më të madhe të pagesave të marra nëpërmjet internetit (7% e totalit të pagesave të marra), krahasuar me bizneset e vogla (vetëm 0.2%) dhe bizneset e mëdha (2.5%). Nga 0.4% e pagesave të pranuar përmes internetit, 79% është për shkak të transfertave elektronike të kreditit, 11% për shkak të debitimit direkt, 6% për shkak të kartës së kreditit dhe 5% për shkak të kartës së debitit.

Kur mbledhen kostot (sipas instrumentit të pagesës) pavarësisht nga madhësia e biznesit, instrumenti i pag-


21. Mund të duket një paradoks që shumica dërrmuese e totalit të pagesave janë marrë nga mikro-ndërmarrjet, por ka disa arsye që e përligjin. Së pari, për shkak të natyrës së tyre, mikro-ndërmarrjet pranojnë shumë pagesa me vlerë të vogël në baza ditore, meqë ato shpesh janë dyqane me pakicë "të lagjes" që ofrojnë mallra dhe shërbime, kundrejt disa bizneseve të mëdha që mund të jenë fabrika dhe nuk kryejnë transaksione aq të shpeshta. Së dyti, mikro-ndërmarrjet përbëjnë një pjesë të madhe të totalit të bizneseve në Shqipëri dhe duke u kombinuar me numrin e shpeshtë të transaksioneve, kjo rrit numrin e përgjithshëm të pagesave që mikro-ndërmarrjet pranojnë në të gjithë vendin.

esës më i kushtueshëm është *cash*-i. Kostoja vjetore e *cash*-it për të gjitha bizneset në Shqipëri arrin në rreth 5 miliardë lekë (\$40 milionë), e ndjekur nga kostoja e transferave të kreditit në formë letër me 2.4 miliardë lekë (\$19.5 milionë), transferat elektronike të kreditit me 870 milionë lekë (\$7 milion), debitimi direkt me 757 milionë lekë (\$6 milionë), kartat e debitit me 541 milionë lekë (\$4.3 milionë) dhe kartat e kreditit me 517 milionë lekë (\$4.1 milionë). Figura 7 përmbledh shpenzimet për të gjitha bizneset sipas instrumentit të pagesës dhe me komponentin e kostos fikse dhe variabël. Është interesante që, sa i përket kostos së *cash*-it në raport me kostot totale, mikro-ndërmarrjet kanë përqindjen më të lartë (*cash*-i përbën 63% të kostove të përgjithshme që mbarohen nga mikro-ndërmarrjet). Bizneset e mesme renditen në vendin e dytë, duke pasur parasysh se kostoja e

cash-it përbën 60% të kostos totale, të ndjekura nga bizneset e vogla (kostoja e *cash*-it përbën 54%) dhe ato të mëdha (kostoja e *cash*-it përbën 37%).

Në total, bizneset në Shqipëri kanë shpenzime vjetore të barabarta me 0.6% të PBB-së në kontekstin e marrjes dhe inicimit të pagesave përmes gjithë instrumenteve të pagesave, ku vetëm *cash*-i përfaqëson 0.3% të PBB-së ose gjysmën e kostove totale. Në krahasim, kostoja e transferave të kreditit në formë letër llogaritet në 0.134% të PBB-së, transferat elektronike të kreditit në 0.048%, debitimet direkte në 0.042%, kartat e debitit në 0.03% dhe kartat e kreditit në 0.028%.

Figura 7: Kostot vjetore të bizneseve sipas instrumentit të pagesës, si përqindje e PBB-së së vitit 2014



IV.3. AGJENCITË QEVERITARE

Të dhënat e kufizuara nuk lejojnë një analizë të detajuar për flukset e pagesave të agjencive qeveritare. Megjithatë, mund të thuhet se në kahun e inicimit, agjencitë qeveritare në Shqipëri kryejnë rreth 17.5 milionë pagesa në vit drejt konsumatorëve (nga ana tjetër, të dhënat Qeveri -Biznes nuk janë në dispozicion). Rreth 50% e të gjitha pagesave të iniciuara nga qeveria janë në *cash*, ndërsa transferat e kreditit në formë letër përbëjnë rreth 20% dhe transferat elektronike të kreditit rreth 30%. Vlerësohet se agjencitë qeveritare marrin një total prej 1.8 milionë pagesash, kryesisht nga konsumatorët me një vëllim vjetor prej rreth 1.3 milion pagesash, si dhe rreth gjysmë milioni pagesash nga bizneset.

Nisur nga ndryshimi në natyrën e këtyre pagesave, analiza e pagesave të qeverisë ndjek një strukturë të ndryshme krahasuar me seksionet e konsumatorit dhe të biznesit. Për shembull, për shumë shërbime të ofruara nga bankat tregtare dhe zyrat postare, që kanë të bëjnë me pagesat e qeverisë, këtyre të fundit nuk u është imponuar asnjë tarifë eksplicite. Për agjencitë qeveritare janë analizuar tre lloje shpenzimesh: kostot e bazuara në kohë (koha e nevojshme për ekzekutimin e transaksioneve mund të konsiderohet si koha e nevojshme për të procesuar pagesën nëpërmjet sistemeve të pagesave të Bankës së Shqipërisë); kostot e komunikimit (kostot kryesore të komunikimit lidhen me ofruesit e internetit dhe komunikimin SWIFT); shpenzimet e infrastrukturës (Sistemi Shqiptar i Thesarit është financuar nga një hua e Grupit të Bankës Botërore dhe mirëmbahet nga buxheti i shtetit). Janë bërë përafrime të kostos në lidhje me


cash-in, transfertat e kreditit në formë letër dhe transfertat elektronike të kreditit, por kostot totale mund të jenë nënvlerësuar ndjeshëm. Në të vërtetë, u theksua se pagesat e qeverive vendore dhe faturat janë fokusuar në Bashkinë e Tiranës: prandaj pjesa e pagesave në *cash* parashikohet të jetë më e lartë jashtë Tiranës, për shkak të depërtimit të dobët të infrastrukturës bankare, duke çuar kështu në kosto edhe më të larta (si dhe mundësi për ulje të koston). Përveç kësaj, pagesat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë plotësisht të lëvruara në *cash*, nuk mund të anketoheshin, prandaj besohet se ato paraqesin fitimet më të larta nga kalimi tek instrumentet elektronike.

Kostoja vjetore e lidhur me *cash-in* është më e larta, me një diferencë të madhe, nga dy instrumentet e tjera të pagesave të përdorura, transfertat e kreditit në formë letër dhe transfertat elektronike të kreditit. Tabela 3 përmbledh shpenzimet totale të vitit 2014 për qeverinë, sipas instrumentit të pagesës. Kostoja vjetore e *cash-it* është 0.016% e PBB-së. Kostoja e dytë më e lartë rezulton nga transfertat elektronike të kreditit, në 0.0035% të PBB-së, ndërkohë që kostoja e tretë më e lartë vjen nga përdorimi i transfertave të kreditit në formë letër, në 0.003% të PBB-së. Arsyeja pse transfertat elektronike të kreditit janë paksa më të kushtueshme në total, sesa transfertat e kreditit në formë letër, qëndron te vëllimi më i madh i transfertave elektronike të kreditit që përdoren në nivel qeveritar në Shqipëri.

Tabela 3: Kostot vjetore për agjencitë qeveritare sipas instrumentit të pagesës (2014)

	CASH-I	TRANSFERTA KREDITI NË FORMË LETËR	TRANSFERTA KREDITI NË FORMË JOLETËR
Qeveria qendrore	—	52 million lek (\$416,000)	66 million lek (\$528,000)
Qeveria lokale	200 million lek (\$1.6 millionë)	—	—
Shërbimet publike	85 million lek (\$680,000)	—	—
Totali	285 million lek (\$2.5 millionë)	52 million lek (\$416,000)	66 million lek (\$528,000)
Totali si % e PPB-së	0.0160	0.0030	0.0035

Figura 8: Vëllimi i pagesave / transfertave të procesuara në formë letër krahasuar me kanalet elektronike ndër vite



IV.4. OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE DHE OFRUESIT E INFRASTRUKTURËS SË PAGESAVE

Në vitin 2016, bankat dhe institucionet e parasë elektronike në Shqipëri procesuan 12 milionë pagesa/transferta²², nga afërsisht 10.2 milionë dhe 11 milionë përkatësisht në vitin 2014 dhe 2015. Nga këto, 44.7% ishin pagesa elektronike në vitin 2016, krahasuar me përkatësisht 33.4% dhe 37.5% në vitet 2014 dhe 2015. Është e domosdoshme që ky moment tranzicioni tek pagesat elektronike (të paktën midis instrumenteve të pagesave jo-cash/elektronike) në vendin tonë, të jetë i qëndrueshëm.

Në terma të vëllimit, transfertat e kreditit përbëjnë shumicën dërrmuese të pagesave të procesuara nga ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP)/ofruesit e infrastrukturës së pagesave (PIP) në Shqipëri. Megjithatë, pjesëmarrja e tyre ka pësuar rënie me kalimin e kohës (për shkak të ritmit të ngadalshëm të rritjes krahasuar me instrumentet e tjera) dhe e sfiduar nga një rritje e shpejtë e pagesave me karta dhe me para elektronike. Pagesat me karta debiti në veçanti mbajnë vendin e dytë në totalin e të gjitha pagesave. Nga ana tjetër, debitimet direkte kanë pësuar një rritje të lehtë gjatë viteve 2014-2015 dhe kanë ruajtur një pozicion statik gjatë viteve 2015-2016.

Përsa i përket normës së rritjes, pagesat me para elektronike/transfertat e procesuara nga kahu i ofertës shfaqën ritmin më të lartë të rritjes në vitin 2016, me rreth 62%, të ndjekura nga pagesat me karta me parapagim me 56%. Në të njëjtën periudhë, pagesat me karta debiti dhe karta krediti janë rritur përkatësisht me 31% dhe 26%. Analiza tregon gjithashtu një tranzicion të vazhdueshëm nga transfertat e kreditit në formë letër/me asistencë në degët e bankave, në transfertat krediti elektronike. Ndërkohë që në vitin 2014 transfertat elektronike të kreditit përbënin 17% të të gjitha transfertave të kreditit të procesuara, në vitin 2016 ato përbënin 23%.

Në vitin 2016, kahu i ofertës të pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri procesoi rreth 22.5 milionë tërheqje *cash*²³ dhe 10.5 milionë depozita²⁴. Tërheqjet e *cash*-it janë rritur me kalimin e kohës, por shkalla e rritjes së tyre është ulur ndjeshëm, nga 27% në 2014-2015, në 7% në vitet 2015-2016. Në mënyrë të ngjashme, depozitat në *cash* shfaqën një rritje të ndjeshme midis viteve 2014 dhe 2015, duke arritur një normë rritjeje prej 94%; megjithatë, norma e rritjes u kthye në negative midis viteve 2015 dhe 2016, pasi depozitat në *cash* pësuan rënie me 14%.

Në përgjithësi, vlerësohet se kahu i ofertës ka një kosto vjetore të barabartë me pothuajse 9 miliardë lekë (\$154 milionë) ose 1.31% të PBB-së së Shqipërisë për vitin 2016, e lidhur me të gjitha instrumentet e analizuarat të pagesave (për ndarjen e hollësishme të kostove për secilin instrument pagese, ju lutem shihni Shtojcën në fund të raportit)²⁵. *Cash*-i shfaqet si instrumenti më i kushtueshëm i pagesave në baza agregate, i barabartë me 0.65% të PBB-së (8.9 miliardë lekë ose \$77 milionë) dhe përgjegjës për gati gjysmën e kostove totale. *Cash*-i ka pothuajse trefishin e kostos së instrumentit të dytë më të kushtueshëm të pagesës, që është karta e debitit, me 0.25% të PBB-së (3.3 miliardë lekë ose \$29 milionë)²⁶. Karta e kreditit renditet e treta me 0.21% të PBB-së (3 miliardë lekë ose \$26 milionë)²⁷, e ndjekur nga transfertat e kreditit me 0.1% të PBB-së (1.3 miliardë lekë ose \$11.5 milionë), debitimi direkt me 0.06% të PBB-së (0.8 miliardë lekë ose \$7 milionë), dhe paraja elektronike që zë 0.04% të PBB-së (0.5 miliardë lekë ose \$4.5 milionë).

22. Pagesat/transfertat, siç janë përcaktuar këtu, përfshijnë vetëm transaksionet e bëra për blerjen e mallrave/shërbimeve, pagesat e detyrimeve të qeverisë dhe transferimet midis palëve, të kryera duke përdorur instrumente elektronike të pagesave, p.sh. duke përfshirë *cash*-in dhe çeket.

23. Këtu janë përfshirë tërheqjet me karta debiti, krediti dhe kartat e parapaguara, meqë transaksione të tilla trajtohen ndarazi nga pagesat me karta, dhe janë të lidhura me transaksionet dhe kostot e *cash*-it. Tërheqjet gjithashtu përfshijnë tërheqjen e parasë elektronike tek agjentët e institucioneve të parasë elektronike.

24. Depozitat përfshijnë depozitimin e *cash*-it tek agjentët e institucioneve të parasë elektronike.

25. Megjithëse kartat e parapaguara janë analizuar nën aspektin e flukseve të volumeve të pagesave dhe të emetimit ndër vite, ato nuk analizohen nën aspektin e kostos për arsye se nuk janë ofruar të dhëna të tilla.

26. Fakti që në total kartat e debitit janë më të kushtueshme se kartat e kreditit vjen kryesisht për shkak të vëllimit më të madh të transaksioneve me karta debiti të procesuara nga kahu i ofertës, në krahasim me kartat e kreditit.

27. Arsyja pse kartat e debitit tregojnë kosto më të lartë sesa kartat e kreditit në total është: edhe pse transaksionet me kartë krediti shoqërohen me tarifa më të larta për transaksion se kartat e debitit, vëllimi më i lartë i transaksioneve me kartë debiti zbeh ndryshimin e tarifës së transaksionit, duke rritur koston e kartave të debitit krahasuar me ato të kartave të kreditit.

Figura 9: Vëllimi i pagesave / transfertave të procesuara sipas instrumentit të pagesës ndër vite




Figura 10: Vëllimi i depozitimeve dhe tërheqjeve të cash-it ndër vite





Figura 11: Kostot vjetore për ofruesit e pagesave dhe ofruesit e infrastrukturës sipas instrumentit të pagesës si përqindje e PBB-së të vitit 2016



Është e rëndësishme për industrinë e kahut të ofertës në Shqipëri që të kuptojë koston mesatare për transaksion të procesuar, bazuar në instrumentin e pagesës dhe mënyrën e transmetimit të përdorur. Kostot e transaksionit janë nxjerrë duke përdorur komponentët e koston variabël²⁸, që lidhen me instrumentet e ndryshme të pagesave dhe metodat e transmetimit.

Procesimi i një transferte krediti në formë letër mban koston më të lartë nga të gjitha transaksionet (550 lekë ose \$4.73); kushton pothuajse nëntë herë më shumë se procesimi i transfertës së barasvlershme nëpërmjet internetit (66 lekë ose \$0.57). Procesimi i një debitimi direkt në formë letër, i cili vjen i dyti në aspektin e koston për një transaksion (460 ose \$3.96), është gjithashtu përafërsisht nëntë herë më i shtrenjtë se përpunimi ekuivalent i një debitimi direkt elektronik (50 lekë ose \$0.43).

Proceset e depozitimeve dhe të tërheqjes së *cash*-it lidhen me pothuajse gjysmën e koston së transaksionit për procesimin e transfertave të kreditit në formë letër dhe debitimeve direkte dhe luhaten nga 200 lekë (\$1.72) në 232 lekë (\$2.00). Konkretisht, depozitimet/tërheqjet *cash* në degët e bankave janë paksa më të kushtueshme se tërheqjet në ATM, pasuar nga proceset depozitim/tërheqje *cash*-i tek agjentët.

Pagesat me karta krediti dhe debiti variojnë nga 170 lekë (\$1.46) deri në 188 lekë (\$1.62), për sa i përket kostove të procesimit për transaksion. Nuk është për t'u habitur që kostot e procesimit të kartës së kreditit janë më të larta sesa kostot e procesimit të kartës së debitit, të nxitura kryesisht nga tarifatat më të larta të shkëmbimit. I njëjti argument shpjegon edhe kostot më të larta të procesimit për pagesat e kartave në distancë/jo me prani fizike në pikën e shitjes (për shembull në internet).

Për çdo transaksion të parasë elektronike, shpenzimet e procesimit qëndrojnë lehtësisht nën koston e procesimit të kartave të pagesave në Shqipëri, duke u luhatur nga 150 lekë (\$1.35) në 157 lekë (\$1.46). Në mënyrë të veçantë, kostoja më e ulët e procesimit korrespondon me transaksionet e parasë elektronike të kanalizuarra nëpërmjet rrjetit të telefonisë celulare dhe me koston më të lartë të përpunimit për transaksionet e kanalizuarra nëpërmjet internetit.

Përveç kostove të transaksioneve, analiza paraqet gjithashtu edhe tregues të kostove që lidhen me aktivitete dhe infrastruktura të ndryshme të rëndësishme në kahun e ofertës së pagesave me vlerë të vogël në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, parashikohet që kostoja mesatare e hapjes së një llogarie bankare në vend, nga këndvështrimi i industrisë, arrin në 322 lekë (\$2.8), ndërsa kostoja mesatare për hapjen e një llogarie të parasë elektronike është 168 lekë (\$1.4). Këto kosto llogariten duke marrë parasysh kohën e shpenzuar në sportel për të hapur llogaritë, kostot e kohës së shpenzuar për trajtimin e *cash*-it, si dhe kosto të tjera të përgjithshme (p.sh. marketingu, pajtueshmëria e rregullave) dhe numrin e llogarive të reja të hapura gjatë vitit 2016.

28. Një komponent kostoje variabël i referohet asaj kategorie të koston që ndryshon kur vëllimi dhe/ose vlera e transaksionit ndryshon.

Figura 12: Kosto për transaksion të procesuar sipas instrumentit të pagesës





Figure 13: Treguesit e koston për industrinë e kahut të ofertës për Shqipërinë (2016)²⁹



29. Kjo metodologji nuk mbleadh të dhëna që do të lejonin llogaritjen e kostove që lidhen me mirëmbajtjen e degëve të bankës.

IV.5. EKONOMIA NË TËRËSI

Në përgjithësi, ekonomia shqiptare mbart kosto të barasvlershme me 2.5% të PBB-së së vendit lidhur me përdorimin, emetimin dhe procesimin e të gjitha instrumenteve të pagesave me vlerë të vogël. Kjo përket përfaqësimin në 33.7 miliardë lekë ose \$290 milionë. Vlen të theksohet se, për të shmangur mbivlerësimin në nivelin e ekonomik, kostot e transferimit midis palëve të interesuara janë hequr nga llogaritjet, pasi ato përbëjnë të ardhura për disa palë të interesuara. Si e fillë, merren parasysh vetëm kostot e burimeve për çdo palë të interesuar për vlerësimin e kostove totale të ekonomisë për instrumentet e ndryshme të pagesave. Për më tepër, duke pasur parasysh se kostot e kahut të kërkesës dhe ofertës i përkasin viteve të ndryshme (2014 dhe 2016 respektivisht), me qëllim të krijimit të një baze të përbashkët

vjetore, shifrat e kahut të kërkesës janë parashikuar/projektuar për vitin 2016 duke përdorur normat e inflacionit. Kështu, të gjitha kostot që i referohen ekonomisë në tërësi/total shoqërohen me vitin kalendarik 2016.


Cash-i zë 1.7% të PBB-së, i ndjekur nga kartat e kreditit me 0.22%, kartat e debitit me 0.21%, transfertat e kreditit në formë letër me 0.2%, ndërsa të gjitha instrumentet e tjera të pagesave së bashku (transferta krediti elektronike, debitimi direkt, paraja elektronike, paratë në internet) përbëjnë 0.17% të PBB-së në terma të koston.

Përsa i përket instrumenteve të pagesave, në nivel ekonomik, instrumentet e pagesave në formë letër janë në shumicën dërrmuese më të kushtueshmet dhe përbëjnë rreth 1.95% të PBB-së në vit. Rreth 50% e koston së pagesave në formë letër përballohen nga konsumatorët, 25%

TABELA 4: KOSTOT TOTALE TË EKONOMISË PËR GJITHË INSTRUMENTET E PAGESAVE ME VLERË TË VOGËL TË SHQYRTUARA (2016)

AKTORËT		LLOJET E KOSTOVE	BURIMET E KOSTOVE	KOSTOT E TRANSFERUARA	KOSTOT TOTALE PËR AKTOR
Kahu i kërkesës	Konsumatorët		12.2 miliardë lek \$105 milionë	6.4 miliardë lek \$55 milionë	18.6 miliardë lek \$160 milionë
	Bizneset		7.8 miliardë lek \$67 milionë	2.8 miliardë lek \$24 milionë	10.6 miliardë lek \$91 milionë
	Agjencitë Qeveritare		328.3 milionë lek \$2.8 milionë	87.8 milionë lek \$0.8 milionë	416.1 milionë lek \$3.6 milionë
Kahu i ofertës	PSPs/PIPs		13.4 miliardë lek \$115.2 milionë	4.6 miliardë lek \$39.6 milionë	18 miliardë lek \$154.8 milionë
Kostot totale në ekonomi			33.7 miliardë lek \$290 milionë 2.5% of GDP		

Figura 14: Kostoja totale e ekonomisë (burimi) sipas instrumentit të pagesës si përqindje e PBB-së së vitit 2016



nga bizneset, 24% nga ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) / ofruesit e shërbimeve të infrastrukturës (PIP) dhe 1% nga agjencitë qeveritare.

Përsa i përket instrumenteve elektronike të pagesave, të cilat kushtojnë rreth 0.55% të PBB-së, rreth 55% e kostove përballohen nga ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) / ofruesit e shërbimeve të infrastrukturës (PIP), 30% përballohen nga konsumatorët, 14% përballohen nga bizneset dhe 1% përballohen nga agjencitë qeveritare.

V. KURSIMET NË EKONOMI

Në përgjithësi, kur zëvendësohet *cash*-i dhe pagesa të tjera në formë letër me pagesa elektronike në nivel ekonomie, vlerësohet se, në shkallët e konvertimit hipotetik prej 35% dhe 70%, Shqipëria mund të gjenerojë kurseme vjetore që variojnë nga 0.5% e PBB-së në 0.9%, ose pothuajse gjysma e kostos së përbashkët të të gjitha instrumenteve të pagesave në formë letër³⁰. Gjithashtu vlen të përmendet se një transferim hipotetik i plotë i transfertave të kreditit në formë letër, do të çojë në kurseme totale prej 9.5 miliardë lekësh ose \$81.7 milionë. Në mënyrë të veçantë, zëvendësimi i transfertave të kreditit në formë letër me transfertat elektronike krediti mund të kursejë 8.2 miliardë lekë ose \$70.5 milionë. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e debitimeve direkte në formë letër, në një skenar zëvendësimi hipotetik prej 100%, kursimet do të arrijnë në 1.3 miliardë lekë ose \$11.2 milionë.

Skenarët hipotetikë të kursemeve janë llogaritur dhe janë raportuar në Tabelën 5. Janë përdorur tre përqindje konvertimi (35%, 70% dhe 100%), për të projektuar kurseme të hollësishme nga kalimi nga pagesat në formë letër, tek ato elektronike, sipas skenarëve të ndryshëm. Për të llogaritur kursimet e mundshme, janë marrë në konsideratë vetëm kostot e burimeve variabël nga të dy kahet si të kërkesës dhe të ofertës. Vlen të theksohet se skenarët e zëvendësimit janë ndërtuar në mënyrë që të lejojnë fizibilitetin. Për shembull, në rastin e zëvendësimit të *cash*-it me transfertat elektronike të kreditit, konsiderohen vetëm pagesat e kryera në degë dhe pagesat e bëra

për faturat e shërbimeve dhe remitancat, duke pasur parasysh se në sistemin aktual të pagesave me vlerë të vogël nuk ka gjasa që pagesat në *cash* të bëra në pikën e shitjes të zëvendësohen me transfertat elektronike të kreditit. Gjithashtu, meqë kahu i ofertës nuk merret me pagesat e kryera me *cash*, ekuivalenti i një pagese me *cash* është një depozitim/tërheqje *cash*-i në një degë banke, e cila mund të zëvendësohet me një transferim elektronik të kreditit; një depozitim/tërheqje *cash*-i në ATM, e cila mund të zëvendësohet me tre blerje me kartë debiti/krediti në pikën e shitjes; një depozitim/tërheqje *cash*-i në një agjent, i cili mund të zëvendësohet me një transfertë paraje elektronike³¹ ose blerje.

Vlen të theksohen skenarët e mëposhtëm të zëvendësimit hipotetik, të cilët supozojnë një normë konvertimi prej 50% dhe fokusohen në një nëngrup instrumentesh, aktorësh dhe/ose rastesh përdorimi, që konsiderohen të kenë ndikimet më të rëndësishme për sistemin shqiptar të pagesave dhe ekonominë në tërësi.

- Në rastin e pagesave të faturave të shërbimeve utilitare, nëse 50% e pagesave të tilla aktuale do të kryheshin nëpërmjet debitimeve direkte elektronike, konsumatorët do të kursenin rreth 750 milionë lekë (\$6.5 milionë), bizneset do të kursenin rreth 1 miliardë lekë (\$8.2 milionë), ndërsa ofruesit e shërbimeve të pagesave-PSP / ofruesit e infrastrukturës-PIP përafërsisht rreth 1.8 miliardë lekë (\$15.5 milionë).

31. Në llogaritje, supozohet se një tërheqje *cash* nga një degë e bankës mund të zëvendësohet me një transferim elektronik krediti ose një debitim elektronik direkt, duke qenë se konsumatorët tipikisht/ normalisht tërheqin *cash* në degët e bankave që janë me vlerë më të madhe se mesatarja, dhe transfertat elektronike të kreditit janë gjithashtu me vlerë më të madhe se mesatarja. Si i fillë, mund të bëhet një supozim i sigurt që e gjithë shuma e parave të tërhequra do të ishte e barabartë me vlerën e kërkuar për transfertën elektronike të kreditit, duke çuar kështu në zëvendësimin 1 me 1. Në rastin e zëvendësimit të *cash*-it me kartën e debitit dhe *cash*-it me kartën e kreditit, në kahun e ofertës, përdoret një raport 1 me 3. Duke përdorur të dhënat e Bankës së Shqipërisë mbi vëllimin dhe vlerën totale të tërheqjeve nga ATM-të dhe pagesave me karta debiti/krediti në POS, mund të nxirren vlerat për transakcion, duke çuar në përfundimin se vlera mesatare e tërheqjes së *cash*-it në ATM është tre herë më e lartë se mesatarja e vlerës së blerjes me kartë debiti/krediti në POS. Për zëvendësimin nga *cash* në para elektronike, në kahun e ofertës, përdoret një raport 1 me 1. Përvoja ndërkombëtare tregon se konsumatorët zakonisht tërheqin të gjithë shumën e parave nga agjenti që një palë tjetër i dërgoi përmes transferimit të parave elektronike. Si i fillë, një zëvendësim 1 me 1 ka kuptim edhe në këtë rast. Për më shumë detaje shih: Banka (2013), M-Pesa në Pikën e Shitjes: Zgjerimi i Përfshirjes Financiare dhe Zvogëllimi i Kërkesës për Cash-in (Gazeta e Strategjisë dhe Sistemeve të Pagesave).

30. Shifra rrjedh nga përdorimi i normës së konvertimit prej 70% për grupin e mëposhtëm të zëvendësimeve: nga *cash*, në transfertë elektronike të kreditit + nga transfertë krediti në formë letër, në transfertë elektronike të kreditit + nga debitimi direkt në formë letër, në debitimin direkt elektronik.

Tabela 5: Skenat e zëvendësimit dhe kursimet në nivel ekonomie

SKENARË ZËVENDËSIMI / FUSHA E KURSIMEVE	KURSIMET: SHKALLA E KONVERTIMIT 35%			KURSIMET: SHKALLA E KONVERTIMIT 70%			KURSIMET: SHKALLA E KONVERTIMIT 100%		
	LEKË	US\$	% E PBB 2016	LEK	US\$	% E PBB 2016	LEKË	US\$	% E PBB 2016
Cash → Transferata elektronike krediti	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.3 miliardë	62.8 milionë	0.526	11.8 miliardë	101.5 milionë	0.850
Cash → Kartë Debiti	1.9 miliardë	16.3 milionë	0.136	3.9 miliardë	33.5 milionë	0.280	7.9 miliardë	68 milionë	0.570
Cash → Debitim direkt elektronik	1.8 miliardë	15.5 milionë	0.130	4.2 miliardë	36.1 milionë	0.302	7.7 miliardë	66.2 milionë	0.554
Cash → Kartë krediti	1.7 miliardë	14.6 milionë	0.122	3.5 miliardë	30.1 milionë	0.252	7.6 miliardë	65.4 milionë	0.548
Cash → Para në internet	1 miliardë	8.6 milionë	0.072	2.1 miliardë	18 milionë	0.150	3 miliardë	25.8 milionë	0.216
Cash → Para elektronike	160 milionë	1.4 milionë	0.012	362 milionë	3.1 milionë	0.026	681.6 milionë	5.9 milionë	0.049
Transferta e kreditit në formë letër → Transfertë elektronike krediti	2.2 miliardë	18.9 milionë	0.160	4.3 miliardë	37 milionë	0.310	8.2 miliardë	70.5 milionë	0.600
Transferata krediti në formë letër → Para në internet	760 milionë	6.5 milionë	0.055	1.5 miliardë	12.9 milionë	0.108	2.7 miliardë	23.2 milionë	0.195
Transferata krediti në formë letër → Para elektronike	312 milionë	2.7 milionë	0.022	760 milionë	6.5 milionë	0.055	1.1 miliardë	9.5 milionë	0.080
Debitimi direkt në formë letër → Debitimi direkt elektronik	460 milionë	4 milionë	0.033	700 milionë	6 milionë	0.050	1.3 miliardë	11.2 milionë	0.094
Debitimi direkt në formë letër → Para elektronike	296 milionë	2.5 milionë	0.020	637 milionë	5.5 milionë	0.046	1.2 miliardë	10.3 milionë	0.086

- Në rastin e pensioneve, nëse gjysma e pensioneve aktuale *cash* do të shpërndaheshin ndryshe nëpërmjet transferatave elektronike të kreditit, kursimet vjetore do të ishin në vlerën 385 milionë lekë (\$3.3 milionë) për konsumatorët, 350 milionë lekë (\$3 milionë) për qeverinë dhe 500 milionë lekë (\$4.3 milionë) për kahun e ofertës.
- Nëse gjysma e remitançave aktuale të dërguara dhe marra do të ishin kanalizuar përmes transferatave elektronike të kreditit, konsumatorët do të kursenin rreth 300 milionë lekë (\$2.6 milionë) çdo vit, ndërsa ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) rreth 800 milionë lekë (\$6.7 milionë).
- Nga ana e biznesit, nëse 50% e pagesave *cash* të biznesit do të zëvendësohen me transferata elektronike të kreditit, bizneset do të kursenin rreth 750 milionë lekë (\$6.5 milionë), ndërsa ofruesit e shërbimeve të pagesave (PSP) rreth 1.6 miliardë lekë (\$13.8 milionë).

VI. PËRFUNDIME

Simulimet e bazuara në ana lizën e kahut të kërkesës dhe të ofertës sugjerojnë që në Shqipëri mund të arrihen përmirësime të konsiderueshme në efikasitet, nëse *cash*-i dhe pagesat e tjera në formë letër, ose një pjesë e tyre,

do të zëvendësoheshin me instrumente elektronike të pagesave me kosto të ulët. Me koston aktuale të pagesave në formë letër në nivel ekonomie që arrin në rreth 1.9% të PBB-së së vendit, kursimet nga një kalim prej 70% të pagesave nga në formë letër në elektronike mund të arrijnë në 0.9% të PBB-së. Ndërkohë që kursimet do të përvetësoheshin nga një numër aktorësh, përfitimet më të mëdha do të ishin për konsumatorët dhe bizneset, të cilët mbajnë edhe pjesën më të madhe të kostove, të ndjekur nga ofruesit e shërbimeve të pagesave/infrastrukturës (PSP/PIP)³².

32. Ndërkohë që një numër vendesh janë në procesin e zbatimit të këtij Udhëzuesi, Gajana e ka përfunduar tashmë procesin. Rezultatet tregojnë se kostoja e lidhur me *cash*-in dhe instrumentet e tjera të pagesave në formë letër (d.m.th. çeqet, dëftesat në formë letër dhe transferatat e kreditit në formë letër) për konsumatorët dhe agjencitë qeveritare, në anën iniciuese dhe pranuese të pagesave me vlerë të vogël, arrin në rreth 2.6% të PBB-së së vendit (përafërsisht \$80 milionë), me 95% të kësaj kostoje që i atribuohet *cash*-it (afërsisht \$76 milionë). Rezultatet gjithashtu tregojnë se vendi potencialisht mund të kursejë deri në 1% të PBB-së së tij (afërsisht \$31 milionë), nëse rreth 75% e transaksioneve aktuale të konsumatorëve dhe transaksioneve qeveritare do të kryheshin nëpërmjet kanaleve elektronike. Në kushtet e rasteve të përdorimit të veçantë, nën supozimin e një shkalle zëvendësimi prej 50%, vendi mund të kursejë deri në \$6 milionë, nëse pagesat e faturave të shërbimeve do të kryheshin nëpërmjet transferatave elektronike të kreditit në vend të *cash*-it dhe rreth \$2 milion nëse pagat do të disbursoheshin/ jepeshin nëpërmjet transferatave elektronike të kreditit në vend të *cash*-it.

Tabela 6: Skenarët e zëvendësimit dhe kursimet për rastet treguese të përdorimit të aktorëve të ndryshëm

Rastet e përdorimit: Pagesat për blerjen e mallrave ushqimore dhe të domosdoshme (P2B) Skenari i zëvendësimit: Cash → Kartë debiti: Konvertimi 50%		
Kursimet për konsumatorët 120 milionë lekë \$1 milionë	Kursimet për bizneset 600 milionë lekë \$5.2 milionë	Kursimet për PSP/PIP 400 milionë lekë \$3.5 milionë
Rastet e përdorimit: Pagesat për faturat utilitare (P2B) Skenari i zëvendësimit: Cash → Debitim direkt elektronik: Konvertimi 50%		
Kursimet për konsumatorët 750 milionë lekë \$6.5 milionë	Kursimet për bizneset 1 miliardë lekë \$8.2 milionë	Kursimet për PSP/PIP 1.8 miliardë lekë \$15.5 milionë
Rastet e përdorimit: Pensionet (G2P) Skenari i zëvendësimit: Cash → Transfertat elektronike të kreditit: Konvertimi 50%		
Kursimet për konsumatorët 385 milionë lekë \$3.3 milionë	Kursimet për agjenci qeveritare 350 milionë lekë \$3 milionë	Kursimet për PSP/PIP 500 milionë lekë \$4.3 milionë
Rastet e përdorimit: Remitancat (P2P) Skenari i zëvendësimit: Cash → Transferta elektronike të kreditit: Konvertimi 50%		
Kursimet për konsumatorët 300 milionë lekë \$2.6 milionë	Kursimet për PSP/PIP 800 milionë lekë \$6.7 milionë	
Rastet e përdorimit: Remitancat (P2P) Skenari i zëvendësimit: Cash → Para elektronike: Konvertimi 50%		
Kursimet për konsumatorët 150 milionë lekë \$1.3 milionë	Kursimet për PSP/PIP 450 milionë lekë \$3.9 milionë	
Rastet e përdorimit: Pagesat e inventarit (B2B) Skenari i zëvendësimit: Transferta krediti në formë letër → Transferta elektronike të kreditit: Konvertimi 50%		
Kursimet për bizneset 750 milionë lekë \$6.5 milionë	Kursimet për PSP/PIP 1.6 miliardë lekë \$13.8 milionë	

Note: B2B = business to business, G2P = government to person, P2B = person to business, and P2P = person to person.

Me uljen e kostove të transaksionit për shkëmbimet e mallrave dhe shërbimeve, një përdorim më efikas i pagesave elektronike mund të sjellë përfitime të konsiderueshme për zhvillimin dhe rritjen ekonomike të vendit. Në rastin e Shqipërisë, shpenzimet më të ulëta mund të kenë potencial për të rritur shtrirjen e shërbimeve *jo-cash* dhe atyre elektronike të pagesave tek familjet me të ardhura më të ulëta dhe shitësit e vegjël, duke përmirësuar efikasitetin e sistemit kombëtar të pagesave, me zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të instrumenteve moderne të pagesave. Në total, rreth gjysma e kostos aktuale të përdorimit të instrumenteve të pagesave mund të kursehet çdo vit në Shqipëri dhe një vlerësim i tillë nuk llogarit efektet e tjera pozitive, ku përfshihet reduktimi i informalitetit dhe të ardhurat më të larta tatimore.

Lind pyetja se çfarë mund të bëhet për të përshpejtuar përparimin e Shqipërisë në uljen e përdorimit të *cash*-it dhe paralelisht në rritjen e pagesave elektronike. Është e rëndë-

sishme të theksohet se disa zhvillime të hershme po na çojnë në drejtimin e duhur. Përgjithësisht, përdorimi i transfertave elektronike të kreditit, debitimit direkt dhe kartave të pagesave ka dëshmuar përmirësime thelbësore; megjithatë, vëllimi i këtyre transaksioneve është ende i ulët krahasuar me vëllimin e përgjithshëm të *cash*-it dhe transaksioneve të tjera në formë letër dhe normat e rritjes janë ende modeste për të arritur skenarët e identifikuar të zëvendësimit, pa një ndërhyrje të mirëmenduar. Edhe produktet e parasë elektronike po tregojnë potencial zhvillimi. Zbatimi i planifikuar i debitimit direkt ndërbankar gjithashtu do të kontribuonte në shërbime më efektive të pagesave të faturave. Megjithatë, mbizotërimi i *cash*-it mund të dëmtojë angazhimin dhe përpjekjet e autoriteteve dhe tregut për rritjen e pagesave elektronike.

Me më pak se 40% të popullsisë së rritur që ka akses në një llogari bankare (dhe më pak se 200,000 llogari të parasë elektronike), aksesin në llogaritë e transaksioneve është një përparësi e rendit të parë për t'u adresuar.

Banka e Shqipërisë, bankat tregtare dhe ofruesit e shërbimeve të pagesave-PSP (duke përfshirë këtu edhe Komitetin Kombëtar të Sistemit të Pagesave) mund të eksplorojnë zbatueshmërinë e ofrimit të një llogarie bazike të transaksionit me pak ose pa kosto për të gjithë individët dhe bizneset që nuk zotërojnë një llogari. Aty ku ka llogari bazike, këto zakonisht rezultojnë nga iniciativa të drejtuara nga tregu, dhe në një masë më të vogël nga kërkesat ligjore/irregulatore. Është po aq e rëndësishme që të gjitha llogaritë e transaksionit të kenë një funksionalitet minimal të caktuar që, të paktën, të mundësojnë dërgimin dhe pranimin e pagesave elektronike me pak ose pa kosto (dhe të ruajnë vlerat monetare në mënyrë të sigurt). Llogaria aktuale dhe oferta e produkteve të pagesave mund të kenë nevojë të rishikohen nën dritën e përmirësimit të dizajnit të përgjithshëm dhe çmimit të përballeshëm. Strategjitë e sektorit publik dhe atij privat duhet të përshtaten me nevojat, zakonet dhe pengesat në zotërimin dhe përdorimin e llogarisë nga palët që qëndrojnë jashtë sistemit bankar dhe janë pamjaftueshmërisht të mbuluara me shërbime bankare (si konsumatorë dhe biznese), si dhe të identifikojnë zgjidhje me objektiva të matshëm. Duhet të inkurajohen risitë teknologjike dhe të modelit të biznesit, që nxisin praninë e bankave, lehtësinë për t'u përdorur dhe uljen e barrierave të besimit.

Pa pranimin universal të pagesave elektronike, shqiptarët nuk kanë ose kanë pak stimuj për të zotëruar dhe/ose përdorur një llogari transaksioni. Nga ana tjetër, duke qenë se pagesat janë një treg i dyanshëm, tregtarët kanë më pak gjasa të pranojnë pagesa elektronike, dhe kërkesa e ulët e konsumatorëve ul më tej interesin e tregtarit. Kjo analizë tregon se në Shqipëri vëllimet e gjeneruara për instrumentet elektronike të pagesave si rezultat i kalimit nga pagesat në *cash* tek ato elektronike në pikën e ndërveprimit do të ishin më të mëdhatë (pagesat e iniciuara nga konsumatorët në *cash* në pikën e ndërveprimit arrijnë në 99 milionë) dhe mund t'u kursejnë bizneseve deri në 600 milionë lekë (\$5,2 milionë) çdo vit. Incentivat e qeverisë dhe industrisë (p.sh. stimujt fiskalë, monetarë, por edhe modelet inovative të biznesit të mbështetura nga teknologjia) mund të jenë të dobishme për të rritur pranimin e pagesave elektronike në pikën e ndërveprimit. Në këtë kontest, përpjekjet për të luftuar informalitetin do të ndikojnë gjithashtu pozitivisht në përshejtimin e kalimit tek pagesat elektronike në pikën e shitjes, duke qenë se informaliteti dhe *cash*-i kanë një marrëdhënie simbioze.

Ndryshimet në metodat e transmetimit të shoqëruara me instrumentet e pagesave në formë letër duket të jenë urgjente pasi ato rezultojnë me kostot më të larta nga perspektiva e përdoruesve. Për shembull, çdo shqiptari i merr mesatarisht rreth 42 minuta për të shkuar, për të pritur në radhë dhe për të kryer një transaksion në një zyrë pagesash, si dhe rreth 29 minuta për të shkuar, për të pritur në radhë dhe për të kryer transaksion në një degë banke. Vëllimet e pagesave në *cash* të trajtuara në degën e bankës kombinuar me koston relative të degës së bankës si një metodë transmetimi sugjerojnë se klientët e bankës mund të përfitojnë nga bankat të cilat zbatojnë modelet e agjentëve, pra duke shkurtuar kostot e bazuara në kohë sidomos në zonat rurale dhe ndoshta duke lehtësuar/ulur gjithashtu barrierat kulturore si dhe të besimit. Zgjerimi i online dhe internet banking dhe shfrytëzimi i parave elektronike si mjet për pagesat e faturave është kritike për të ndërprerë metodat e tjera të kushtueshme të transmetimit të pagesave *cash* dhe instrumenteve të pagesave në formë letër (p.sh. zyra e pagesës).

Analiza gjithashtu thekson se bankat mbartin kosto të konsiderueshme nga kartat e pagesave, në një masë të madhe të nxitur nga vëllimi (sidomos për kartat e debitit), por edhe si rezultat i tarifave të procesimit të kartave. Në mënyrë të veçantë, nga të gjitha kostot e lidhura me kartën e debitit, rreth 31% i dedikohet tarifave variabël dhe fikse (p.sh. procesimi i të dhënave, tarifat e licencës, tarifat e shkëmbimit) dhe të gjitha kostot e lidhura me kartën e kreditit, kanë pothuaj të njëjtën përqindje, 31%, e cila shkon për tarifat variabël dhe fikse. Procesimi i kartave lokale, në rrethana të caktuara, mund të kontribuojë në uljen e disa prej këtyre kostove, të cilat janë strategjikisht operacionale për bankat (duke pasur parasysh rritjen e transaksioneve me kartat e pagesave) dhe sistemin e pagesave në tërësi (p.sh. si rezultat i qeverisjes dhe vendimmarrjes vendore).

Në përgjithësi, edhe pse *cash*-i ende mbizotëron dhe është mjaft i kushtueshëm për Shqipërinë, ka shenja premtuese. Megjithatë, nuk mjaftojnë vetëm tendencat për ndryshime, por nevojiten veprime të matura nga industria, autoritetet qeveritare dhe Banka e Shqipërisë, në mënyrë që të materializohen ndryshimet e nevojshme në terren për të përshejtuar kalimin në pagesa elektronike.

NDARJA E KOSTOVE PËR KAHUN E OFERTËS SIPAS INSTRUMENTIT TË PAGESËS

CASH-I

Kostot e bazuara në kohë, lidhur me depozitat/tërheqjet në sportel, si dhe trajtimin e cash-it të zyrës back office, përbëjnë rreth 35% të të gjitha kostove vjetore të cash-it. Shpenzimet e përgjithshme zënë rreth 18% të të gjitha kostove të cash-it dhe ato përfshijnë marketingun/reklamat, si dhe pajtueshmërinë/përputhshmërinë.³³ Shpenzimet e sigurisë përbëjnë rreth 16% dhe përfshijnë mirëmbajtjen e kasafortave, siguracionin, parandalimin e mashtrimit dhe humbjet/vjedhjet. Kostot e mirëmbajtjes së ATM-ve janë të afërta me ato të sigurisë, dhe llogariten në rreth 15.5% të kostos së cash-it, e ndjekur nga transporti i monedhës, që zë rreth 14%. Shtypja e monedhës, e cila është një aktivitet i kryer nga Banka e Shqipërisë, vlerësohet në rreth 1.5% të të gjitha kostove të cash-it dhe përfshin shtypjen e kartëmonedhës dhe të monedhës. Nuk duhet të çudisë që ky komponent i kostos është i vogël krahasuar me komponentët e tjerë, pasi shtypja dhe prodhimi i monedhës së re nuk ndodh me të njëjtin intensitet çdo vit.

Ndarja në zëra gjithashtu mundëson alokimin, deri në një farë mase, të kostove për pikat e ndryshme të aksesit. Konkretisht, kostoja e mirëmbajtjes së ATM-ve prej 1.4 miliardë lekësh (\$12 milionë), që përbën rreth 15.5% të të gjitha kostove të cash-it, është me interes të veçantë për industrinë, pasi ajo del si komponent i rëndësishëm i kostos, i lidhur drejtpërsëdrejti me ATM-të. Në mënyrë të ngjashme, shpenzimet e bazuara në kohë (sporteli dhe zyra back office) si dhe kostot e sigurisë dhe kostot e transportit të monedhës mund të lidhen me operacionet e degëve. Në mënyrë të veçantë, këta përbërës

33. Duke qenë se kostot e përgjithshme lidhen me instrumente të shumfishta pagesash, ato lidhen me secilin instrument veçmas duke përdorur vëllimin e pagesave të procesuara si peshë për shpërndarjen e pjesëve përkatëse.

të kostos përbëjnë bashkërisht rreth 65% të të gjitha kostove të cash-it ose 5.6 miliardë lekë (\$48 milionë).

KARTAT E DEBITIT

Bankat tregtare në Shqipëri mbartin një kosto vjetore lidhur me kartat e debitit prej afërsisht 3.3 miliardë Lekë (rreth \$29 milionë) ose 0.25% të PBB-së së vendit. Duke hequr mënjatë shpenzimet e përgjithshme, të cilat llogariten në 26% të të gjithë kostove të kartave të debitit, gjithë llojet e tarifave të marra së bashku llogariten në rreth 38% të kostove totale të kartave të debitit (zëri kryesor i kostove).

Duke përjashtuar shpenzimet e përgjithshme, tarifat e procesimit të të dhënave, të cilat janë tarifat për transaksion, të paguara në rrjetin e kartave për lehtësimin e transaksioneve me kartë debiti, llogariten në rreth 15%. Tarifat e shkëmbimit (paguar bankave emetuese) përbëjnë 9% të kostove. Tarifat e shlyerjes, të paguara për transaksionet në monedhë vendase dhe në valutë, përbëjnë rreth 7.3% të kostove. Tarifat e licencës, të cilat janë tarifa fikse të paguara për rrjetin e kartave në baza mujore/vjetore për markën, përbëjnë 6.6% të të gjitha kostove të kartës së debitit.

Në përgjithësi, rreth 23% e të gjitha kostove që mbarten nga bankat janë tarifa fikse dhe variabël të paguara çdo vit për kompanitë e kartave (ose 58% e të gjitha tarifave të paguara), rreth 9% e kostove janë tarifa (shkëmbimi) të paguara tek bankat emetuese (23% e të gjitha pagesave të paguara), dhe 7% e kostove janë tarifat e shlyerjes për transaksionet në monedhën vendase dhe në valutë (ose 19% e të gjitha tarifave të paguara).

Përsa i përket komponentëve të tjerë të kostos, mirëmbajtja e sistemeve së teknologjisë së informacionit, që mbulon zhvillimet software dhe hardware për ndërlidh-

Jet me rrjetet dhe infrastrukturën e tjera të centralizuara që lejojnë transaksionet me karta debiti, përbëjnë rreth 8.5% të kostove të përgjithshme. Kostot e prodhimit të kartave janë në të njëjtin nivel (rreth 8.2% të kostove) dhe përfshijnë regjistrimin me kompaninë e kartave, blerjen e plastikës dhe të çipave, si dhe personalizimin dhe regjistrimin në zyrën e brendshme (PayLink). Menaxhimi i POS-ve përbën një përqindje pak më të ulët, rreth 7% të kostos, e ndjekur nga kostot e sigurisë (parandalimi i mashtrimit, siguracionit, humbjet/vjedhjet) në rreth 6%, dhe programet e besnikërisë për klientët, në rreth 6%.

Ndarja e komponentëve të kostos lejon disa ndarje të kostove sipas pikave të aksesit. Në mënyrë të veçantë, duke pasur parasysh se tarifat e shkëmbimit dhe procesimit të të dhënave janë pak më të larta për transaksionet e kartave jo të pranishme kundrejt transaksioneve fizike me kartë debiti në pikat POS, dhe gjithashtu duke përdorur pjesën e transaksioneve në internet dhe POS, mund të konkludohet se nga të gjitha kostot e kartës së debitit, rreth 5% lidhen me transaksionet në internet, 55% me transaksionet fizike në POS dhe pjesa tjetër prej 40% përbëhet nga shpenzimet e përgjithshme, prodhimi i kartave dhe programet e besnikërisë, të njohura ndryshe si operacionet e përgjithshme.

KARTAT E KREDITIT

Bankat tregtare në Shqipëri mbartin për kartat e kreditit, një kosto vjetore prej rreth 3 miliardë lekësh (\$26 milionë) ose 0.21% të PBB-së vjetore të vendit. Shpenzimet e përgjithshme mbulojnë rreth 30% të kostove totale, ndërsa tarifat, së bashku, përbëjnë afërsisht 38% të kostove totale të kartës së kreditit, me koston e mbetur të ndarë midis prodhimit të kartave, mirëmbajtjes së POS-eve, sistemeve të teknologjisë së informacionit, programeve të besnikërisë dhe sigurisë. Të gjitha ndarjet e kostove (por jo ato aktuale) për kartat e kreditit janë identike me ato të paraqitura për kartat e debitit.³⁴

34. Duke qenë se disa nga komponentët e kostove janë raportuar bashkërisht për kartat e debitit dhe të kreditit, shpërndarja e kostove për komponentët e kostos variabël (përfshirë tarifat e transaksionit si tarifat e procesimit të të dhënave, tarifat e shkëmbimit dhe pagesat e shlyerjes) është arritur duke përdorur ndarjen e vëllimit midis kartave të debitit dhe atyre të kreditit. Megjithatë, për komponentët fikse të kostos si tarifat e licencës, është përdorur informacion nga burim dytësor, industria. Më konkretisht, 60% të tarifave të licencës i takojnë kartave të kreditit dhe 40% kartave të debitit. Në përgjithësi, tarifat zënë të njëjtën përqindje të përafërt të kostove për kartat e debitit dhe të kreditit, megjithatë, ndarjet janë të ndryshme. Duhet të theksohet se ndërsa transaksionet me kartë debiti të procesuara janë më të larta në krahasim me kartat e kreditit, tarifat për një transaksion për kartat e kreditit (p.sh. procesimi i të dhënave, shkëmbimi, shlyerja) janë më të larta për kartat e kreditit sesa për kartat e debitit.

Duke mënjanuar kostot e përgjithshme, kostot e procesimit të të dhënave renditen si komponenti më i lartë i kostos dhe përbëjnë 13% të kostove totale, të ndjekura nga tarifat e licencës dhe tarifat e shkëmbimit, përkatësisht me rreth 11% dhe 8% të kostove totale. Tarifat e shlyerjes për transaksionet në monedhën vendase dhe në valutë, renditen akoma më poshtë, pas mirëmbajtjes së sistemit dhe prodhimit të kartave, në rreth 6.5% të të gjitha kostove.

Tarifat e paguara për kompaninë e kartës përbëjnë rreth 24% të kostove totale (ose 63% e gjithë tarifave të paguara), ndërsa ato që paguhen për bankat emetuese përbëjnë rreth 8% të të gjitha kostove (ose 20% e gjithë tarifave të paguara). Tarifat e shlyerjes përbëjnë rreth 6% të të gjitha kostove (ose 17% e gjithë tarifave të paguara).

Komponentët e tjerë të kostos përfshijnë mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke përbërë rreth 7% të kostove, prodhimin e kartave, në 7%, mirëmbajtjen e POS-eve në rreth 6%, programet e besnikërisë në 6% dhe sigurinë në pothuajse gati 6% të kostove.

Ashtu si dhe në rastin e kartave të debitit, mund të nxirret gjithashtu një shpërndarje e kostos nga pika e aksesit për kartat e kreditit, duke përdorur një qasje të ngjashme. Proceset e kartave të kreditit të procesuara në internet përbëjnë rreth 24% të kostove totale të kartës së kreditit, ndërsa aktivitetet e procesuara të kartës së kreditit në POS-e fizike (duke përfshirë edhe mirëmbajtjen e POS-eve) përbëjnë rreth 26% të të gjitha kostove, ndërsa 50% i mbetur përbëhet nga kostot e përgjithshme, programet e besnikërisë dhe siguria.

TRANSFERTAT E KREDITIT

Bankat tregtare kanë për transfertat e kreditit, një kosto vjetore prej 1.3 miliardë lekësh (\$11.5 milionë) ose 0.1% e PBB-së së vendit. Përveç kostos së përgjithshme që përbën 33% të të gjitha kostove, zëri i vetëm më i madh është ai i tarifave të procesimit me 16% (për transfertat ndër-bankare të kreditit), pasuar nga kostoja e mirëmbajtjes së teknologjisë së informacionit në 14%, koha e transaksionit në sportel në 12%, arkivimi i formave të letrës dhe procesi tjetër i lidhur me zyrën back office në rreth 11%, lëshimi (d.m.th. prodhimi dhe transportimi në degë) i formularëve të transfertave të kreditit në 8% dhe siguria (p.sh. parandalimi i mashtrimit dhe humbjet/vjedhjet) në 7%.

Ajo që është interesante të vërehet është se së bashku, të gjitha aktivitetet që lidhen me transfertat e kreditit në formë letër (kostoja e kohës në sportel, arkivimi dhe lëshimi i formularëve për transfertat në formë letër) për-

bëjnë 30% të kostove totale. Me fjalë të tjera, të gjitha proceset që kanë të bëjnë me transfertat e kreditit në formë letër i kushtojnë bankave rreth 404 milionë lekë (\$3.6 milionë).

Vëzhgimi i lartpërmendur lidhur me kostot e transfertave të kreditit në formë letër, së bashku me të dhënat e tarifës së procesimit dhe pjesën e transfertave të kreditit në formë letër dhe elektronike, lejon një ndarje të kostove sipas kanaleve të aksesit (për shembull të ndihmuara nga dega e bankës/formë letër përkundrejt elektronike/internet). Në të vërtetë, rrjeti i degëve/pikat e aksesit lidhet me 44% të të gjithë kostove të transfertave të kreditit (590 milionë lekë ose \$5 milionë), 16% me kanalin e Internetit (213 milionë lekë ose \$1.8 milionë) dhe 60% tjetër i mbetur (800 milionë lekë ose \$7 milionë) janë shpenzimet e përgjithshme dhe të sigurisë.

DEBITIMI DIREKT

Bankat tregtare mbartin një kosto vjetore të debitimit direkt prej rreth 800 milionë Lekë (\$7 milionë) ose 0.06% të gjithë PPB-së së Shqipërisë. Përveç 48% të kostove të përgjithshme, arkivimi i mandatit letër të debitimit direkt renditet si komponenti i vetëm më i madh i koston, që përbën rreth 16% të koston totale. Mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit e ndjek me rreth 10% të kostove, koha e transaksionit në sportel për mandatin e debitimit direkt në formë letër me rreth 9%, lëshimi i formateve letër me rreth 9%, dhe siguria me afërsisht rreth 8% të të gjitha kostove. Të gjithë komponentët e koston të prezantuar nën debitimin direkt janë të njëjta me ato të prezantuara tek transfertat e kreditit.³⁵ E vetmja diferencë është që për debitimin direkt nuk ka kosto procesimi, duke marrë parasysh që aktualisht në Shqipëri procesohen vetëm debitimet direkte brenda të njëjtës bankë .

Së bashku, të gjitha aktivitetet që lidhen me debitimet direkte në formë letër (kostoja e kohës së shpenzuar në sportel, arkivimi dhe lëshimi i formateve letër të debitimit direkt) përbëjnë 34% të të gjitha shpenzimeve. Me fjalë të tjera, të gjitha proceset që lidhen me debitimet direkte në formë letër, i kushtojnë bankave në vit rreth 287 milionë lekë (\$2 milionë). Shpenzimet e lidhura me rrjetin elektronik (p.sh. internet) përbëjnë 10% të të gjitha shpenzimeve (80 milionë lekë ose \$0.7 milionë), ndërsa 56% e koston së mbetur përbëhet nga shpenzimet e përgjithshme dhe të sigurisë.

35. Duke marrë parasysh që kosto të caktuara janë raportuar bashkërisht si për transfertat e kreditit dhe debitimet direkte, ndarja e kostove u arrit duke përdorur ndarjen e vëllimit të transfertave të kreditit dhe debitimeve direkte.

PARAJA ELEKTRONIKE

Institucionet e parasë elektronike në Shqipëri mbartin një kosto vjetore prej 525 milionë lekësh (\$4.5 milionë) ose 0.04% të PBB-së së vendit. Duke përjashtuar 43% të koston së përgjithshme, pjesa e mbetur prej 57% ndahet si më poshtë: kostot e lidhura me agjentët (tarifat e komisioneve dhe trajnimet) renditen të parat me 19.5% të koston totale; aksesi dhe mirëmbajtja e telefonisë celulare me 13%; aksesi dhe mirëmbajtja e sistemit në internet me 8%; shërbimi ndaj klientit në zyrën e back office (adresimi i pyetjeve lidhur me paranë elektronike) me rreth 7%; siguria (parandalimi i mashtrimit, humbjet/vjedhjet, siguracionet) me 5%; tarifat përveç komisionit të agjentëve (tarifat rregulatore, pagesa e auditimit, anëtarësimi në shoqata të ndryshme) me rreth 4.5%.

Në përgjithësi, agjentët i kushtojnë institucioneve të parasë elektronike një shumë vjetore prej rreth 102 milionë lekësh ose \$0.9 milionë, duke përbërë 19.5% të të gjitha kostove të parasë elektronike.³⁶ Sa i përket metodave të tjera të transmetimit, aktivitetet që lidhen me procesimin e rrjetit të telefonisë celulare arrijnë në vit në rreth 68 milionë lekë ose \$0.6 milionë (13% të të gjitha kostove), ndërsa ato që lidhen me procesimin online arrijnë në rreth 43 milionë lekë ose \$0.4 milionë (përafërsisht 8% e kostove totale). Duhet përmendur se kostoja më e lartë për transaksion për procesimin e transaksioneve përmes internetit krahasuar me transaksionet e parasë elektronike përmes rrjetit të telefonisë celulare (e nxjerrë në një nga seksionet e mëparshme) justifikohet kryesisht nga shkalla e ulët e transaksioneve të parasë përmes internetit.

36. Jo të gjitha kostot e lidhura me agjentët e parasë elektronike kanë të bëjnë me paratë elektronike, duke pasur parasysh se agjentët janë të përfshirë në një numër të madh procesesh të hyrje-daljeve të cash-it. Në të vërtetë, kjo metodologji ka ndarë një pjesë të kostove të agjentëve për cash-in (bazuar në vëllimin e proceseve të hyrje-daljeve të cash-it) dhe pjesën e mbetur (bazuar në kërkesat që lidhen me paranë elektronike) për paranë elektronike.

SHEMBUJ TË PYETËSORËVE TË ANKETIMIT

HAPËSIRA INFORMUESE 2

Shembuj të pyetjeve për pyetësin e konsumatorëve

Seksioni 1: Vëllimi dhe vlera e pagesave

1. Në një muaj të zakonshëm, a pranoi të paktën një transferim të fondeve nga të afërmit dhe/ose miqtë pa shkëmbyer mallra/shërbime?

Po Jo

Nëse "po", vazhdoni me pyetjet e mëposhtme, përndryshe vazhdoni me rastin tjetër të përdorimit.

2. Sa shpesh i merrni këto pagesa në një muaj të zakonshëm? _____ nr. i herëve

3. Cili është instrumenti/et e pagesës nëpërmjet të cilave ju merrni transfertën?

Cash Transfertë krediti Para në celular

4. Sa nga këto pagesa merrni nëpërmjet kanaleve të mëposhtme të shërbimit?

DEGË AGJENT INTERNET TELEFON

Përgjigjet në: Numër Përqindje

Seksioni 2: Kostot e elementeve të pagesave

1. Kur vizitoni pikat e mëposhtme të shërbimit, sa kohë ju duhet zakonisht për të arritur atje? Ju lutem përgjigjuni në minuta.

DEGË ATM AGJENT ZYRË PAGESE

2. Sa paguani zakonisht në tarifa, kur tërhiqni cash në pikat e shërbimit në vijim? Ju lutem përgjigjuni në monedhën lokale.

DEGË ATM AGJENT

3. Sa kohë (në minuta) merr mesatarisht për të iniciuar një pagesë përmes një prej instrumenteve të pagesave të mëposhtme - që nga momenti kur filloni të futni të dhënat deri në përfundimin e pagesës?

KARTË DEBITI KARTË KREDITI TRANSFERTË DIREKTE KREDITI PARA NË CELULAR

Seksioni 3: Të dhënat social-demografike

1. A keni akses në një llogari nëpërmjet të cilës ju mund të bëni dhe të merrni pagesa? Po Jo

2. A përdorni ju personalisht internet banking? Po Jo

HAPËSIRA INFORMUESE 3

Shembuj të pyetjeve për sondazhin e biznesit

Seksioni 1: Vëllimet, vlerat dhe shpërndarja e transaksioneve të pagesave të iniciuara dhe të marra

1. Sa transaksione keni marrë me secilin instrument pagese gjatë vitit të kaluar fiskal për (shëno rastin e përdorimit)? Cila ishte vlera mesatare për transaksion nga instrumenti i pagesës?

INSTRUMENTI I PAGESËS	NUMRI I TRANSAKSIONEVE	VLERA MINIMALE E TRANSAKSIONIT	VLERA MAKSIMALE E TRANSAKSIONIT
Cash-i			
Karta debiti			
Karta krediti			
Transfertat e Debitimit Direkt			
Transfertat e Kreditimit Direkt			
Paraja në celular			
Totali			

Seksioni 2: Elementet e kostos së pagesave

1. Sa kohë ju duhet që të pranoni një pagesë në pikën e ndërveprimit: nga koha që njoftoni shumën derisa transaksioni të jetë përfunduar? Ju lutemi vlerësoni në minuta/sekonda për transaksion.

CASH-I KARTA DEBITI KARTA KREDITI TRANSFERTË DIREKTE DEBITI TRANSFERTË DIREKTE KREDITI PARA NË CELULAR

2. Sa paguan biznesi juaj në tarifa/komisione tek bankat për depozitimin e cash-it në muaj? _____ (në monedhën vendase)

3. Mesatarisht, sa paguani çdo muaj për pagesat e komunikimit që lidhen me pranimin e instrumenteve të mëposhtme të pagesave në pikën e ndërveprimit?

KARTA DEBITI KARTA KREDITI PARA NË CELULAR

Seksioni 3: Informacion mbi biznesin

1. Emri i Kompanisë (opsional): _____
2. Personi i Kontaktit (opsional):: _____
3. Numri i punonjësve me kohë të plotë: _____ punonjësit me kohë të pjeshme: _____
4. Paga mesatare për orë e paguar për vitin e kaluar fiskal për punonjës _____ (në monedhën vendase).

HAPËSIRA INFORMUESE 4

Shembuj të pyetjeve për sondazhin e agjencisë qeveritare

Seksioni 1: Vëllimet, vlerat dhe shpërndarja e pagesave të iniciuara dhe të marra

1. Cila është përqindja e shpërndarjes së pagesave të INICIUARA me secilin instrument pagese nëpërmjet çdo shërbimi gjatë vitit të kaluar fiskal?

METODA E TRANSMETIMIT	INSTRUMENTI I PAGESËST					
	CASH-I	KARTA DEBITI	KARTA KREDITI	TRANSFERTA DIREKTE DEBITI	TRANSFERTA DIREKTE KREDITI	PARA NË CELULAR
Pika e ndërveprimit						
Dega						
ATM						
Pika e agjentit						
Zyra e Pagesës						
Interneti/Linjat e përcaktuara						
Telefoni/rrjeti i telefonisë celulare						
Totali	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Seksioni 2: Elementet e Kostos së Pagesave

1. Sa paguani për një muaj tek ofruesit e shërbimeve të pagesave (p.sh. pikë agjenti, degë banke, etj.) për mbledhjen e pagesave në emrin tuaj? _____ (në monedhën vendase)
2. Ju lutem raportoni kohën e shpenzuar nga ju ose nga punonjësit tuaj mesatarisht në një javë për kontrollin e deklaratave të llogarive bankare. _____ orë _____ minuta

Seksioni 3: Informacion i Agjencisë Qeveritare

1. Emri i Agjencisë (opsional): _____
2. Personi i Kontaktit (opsional): _____
3. Numri i pikave: _____
4. Numri i qendrave të pagesave: _____
5. Numri i llogarive bankare: _____

HAPËSIRA INFORMUESE 5

Shembuj pyetjesh për pyetëtorët e ofruesve të shërbimeve të pagesave

Seksioni 1: Vëllimet, vlerat dhe shpërndarja e pagesave të procesuara

1. Për kartat e debitit të emetuara nga institucioni juaj, sa transaksione janë iniciuar përmes secilit kanal/rrjet të shërbimit gjatë vitit të kaluar dhe cila ishte vlera mesatare për transaksion?

METODA E TRANSMETIMIT	NUMRI I TRANSAKSIONEVE	SHUMA MESATARE E TRANSAKSIONIT NË MONEDHËN VENDASE)
Pika e ndërveprimit		
Dega		
ATM		
Pika e agjentit		
Zyra e pagesës		
Interneti/Linjat e përcaktuara		
Telefoni/rrjeti i telefonisë celulare		

Seksioni 2: Elementet e Kostos së Pagesave

1. Cilat janë kostot tipike të prodhimit që ju hasni për secilën kartë debiti të emtuar?

	KOSTO PËR KARTË DEBITI DEBITI (NË MONEDHËN VENDASE)	NUMRI MESATAR I KARTAVE TË EMETUARA PËR NJË VIT
Prodhimi		
Personalizimi		
Shpërndarja tek Klienti		

Personalizimi u krye: Në shtëpi Nga një PSP/PIP Nga një palë e tretë

Seksioni 3: Informacion mbi Ofruesin e Shërbimit të Pagesave (PSP)

- Emri i kompanisë (opsional): _____
- Personi i kontaktit (opsional): _____
- Numri i degëve: _____
- Numri i punonjësve me kohë të plotë: _____ Punonjësit me kohë të pjesshme: _____
- Paga mesatare për orë e paguar për vitin e kaluar fiskal për punonjës _____ (në monedhën vendase)

REFERENCA

Banka, Holti. 2013. "M-PESA në pikën e shitjes: Zgjerimi i Përfshirjes Financiare dhe Zvogëlimi i Kërkesës për Paranë fizike". Strategjia e Gazetave të Pagesave dhe Sistemet 7, nr. 4 (dimër): 359-69.

Demirgüç-Kunt, Asli, Leora Klapper, Dorothe Singer, Saniya Ansar, and Jake Hess. 2018.

Baza e të dhënave të Global Findex 2017: Matja e Përfshirjes Financiare dhe Revolucioni Fintech. Uashington, DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore.

<https://globalfindex.worldbank.org/>

INSTAT (Instituti i Statistikave Shqiptari. <http://www.instat.gov.al/en/>

Banka Botërore. 2016. Pagesat me vlerë të Vogël: Një Udhëzues Praktik për Matjen e Kostove të Pagesave me Vlerë të Vogël. Uashington, DC: Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore.

<http://documents.worldbank.org/curated/en/255851482286959215/pdf/111216-WPP155382->

[PUBLIC-ABSTRACT-SENT.pdf](#)

